



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës : KSC-BC-2023-12/IA006 dhe IA007

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 28 tetor 2025

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: **Publik**

**Vendim mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së
Thaçit në lidhje me Juridiksionin dhe Vendimit mbi Mocionet Paraprake për
Shtyrje dhe Veçim të Procesit**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:
Sofi Menegon

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Isni Kilajt:
Ian Eduards

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit:
Aleksandër Admiral

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, "Paneli i Gjykatës së Apelit", "Paneli i Apelit" ose "Paneli" dhe "Dhomat e Specializuara"),¹ bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ("Rregullorja"), ka marrë në shqyrtim dy apele ("Apelin për Shtyrjen e Procesit" dhe "Apelin për Juridiksionin", bashkërisht "Apelet"), të Hashim Thaçit ("Thaçi", "i akuzuari" ose "Mbrojtja")² kundër Vendimit të Gjykatës së Procedurës Paraprake mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit ("Vendimi i Apeluar mbi Shtyrjen e Procesit") dhe Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin ("Vendimi i Apeluar mbi Juridiksionin") (bashkërisht, "Vendimet e Apeluara").³ Më 28 gusht 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi Përgjigje ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit ("Përgjigja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit"), dhe më 29 gusht 2025, Përgjigjen ndaj Apelit për Juridiksionin ("Përgjigja ndaj Apelit për Juridiksionin") (bashkërisht, "Përgjigjet"), ku parashtroi se Apelet duheshin rrëzuar në tërësi.⁴ Më 2 shtator 2025,

¹ IA006/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 25 korrik 2025. IA007/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 25 korrik 2025.

² IA006/F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Apelit të Mbrojtjes së Thaçit kundër Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit, 20 gusht 2025 (versioni konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 18 gusht 2025, versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 20 gusht 2025) ("Apeli për Shtyrjen e Procesit"); IA007/F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Apelit të Mbrojtjes së Thaçit kundër Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin, 20 gusht 2025 (versioni konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 18 gusht 2025, versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 20 gusht 2025) ("Apeli për Juridiksionin") (bashkërisht, "Apelet"). Më 28 korrik 2025, Paneli i Apelit miratoi zgjatjen e afatit për parashtrimin e apeleve të Thaçit deri më 18 gusht 2025. Shih IA006/F00003, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Afatit për Parashtrimin e Apeleve, 28 korrik 2025; IA007/F00003, Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Afatit për Parashtrimin e Apeleve, 28 korrik 2025; Shih gjithashtu IA006/F00001, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Afatit për Parashtrimin e Apeleve, 25 korrik 2025; IA007/F00001, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Afatit për Parashtrimin e Apeleve, 25 korrik 2025.

³ F00354/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit, 1 korrik 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 30 qershor 2025) ("Vendimi i Apeluar mbi Shtyrjen e Procesit"); F00343, Vendim mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit për Juridiksionin, 19 qershor 2025 ("Vendimi i Apeluar mbi Juridiksionin").

⁴ IA006/F00005, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apelit të Mbrojtjes së Thaçit kundër Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit, 28 gusht 2025 (konfidencial dhe *ex parte*) ("Përgjigje ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit"); IA007/F00005, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apelit të

Thaçi dorëzoi kundërpërgjigje në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit ("Kundërpërgjigja në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit"), dhe më 2 shtator 2025 dorëzoi kundërpërgjigje në kuadër të Apelit për Juridiksionin ("Kundërpërgjigja në kuadër të Apelit për Juridiksionin").⁵

I. HISTORIKU

1. Në lidhje me procesin gjyqësor në çështjen KSC-BC-2020-06 ("Çështja 06"), më 1 maj 2024, ZPS-ja dorëzoi kërkesë për përfshirjen në listën e provave materiale të saj të materialeve të dorëzuara si rezultat i zbatimit të masave hetimore të posaçme të autorizuara prej Gjykatësit të Vetëm në lidhje me, ndër të tjerë, Thaçin, për vepra penale të pengimit të procesit gjyqësor sipas nenit 15(2) të Ligjit, që pretendohet të jenë kryer në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("materialet në lidhje me pengimin").⁶ Më 22 gusht 2024, Trupi Gjyqësor II lëshoi vendim me të cilin miratoi kërkesën e ZPS-së.⁷ Më 15 prill 2025, ZPS-ja dorëzoi një mocion me të cilin kërkoi, ndër të tjera, pranimin si prova të materialeve në lidhje me pengimin.⁸ Më 29 maj 2025, Trupi Gjyqësor II lëshoi një vendim me të cilin miratoi pjesërisht mocionin e

Mbrojtjes së Thaçit kundër Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit për Juridiksionin, 29 gusht 2025 (konfidencial dhe *ex parte*) ("Përgjigje ndaj Apelit për Juridiksionin");

⁵ IA006/F00007, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apelit kundër Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit, 2 shtator 2025 (konfidencial dhe *ex parte*) ("Kundërpërgjigja në kuadër të Apelit për Shtyrjen të Procesit"); IA007/F00006, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apelit kundër Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Juridiksionin, 3 shtator 2025 (konfidencial dhe *ex parte*) ("Kundërpërgjigja në kuadër të Apelit për Juridiksionin");

⁶ KSC-BC-2020-06, F02279/RED, Version i Redaktuar Publik i Kërkesës së Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale me Shtojcën 1, konfidenciale, 6 shtator 2024, (versioni konfidencial u dorëzua më 1 maj 2024).

⁷ KSC-BC-2020-06, F02501/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale (F02279) dhe mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit për Mospranimin e Materialeve *in Limine*, 20 dhjetor 2024, (versioni konfidencial u dorëzua më 22 gusht 2024).

⁸ KSC-BC-2020-06, F03120, Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Materialeve në lidhje me Pengimin, 15 prill 2025.

ZPS-së dhe pranoi si prova materialet në lidhje me pengimin ("Vendimi për Materialet në lidhje me Pengimin në Çështjen 06").⁹

2. Në lidhje me Çështjen 12, më 6 qershor 2024, Kryetarja caktoi gjykatësen Masëlo si Gjykatëse të Vetme në procedurat në kuadër të KSC-BC-2018-01.¹⁰ Gjithashtu, më 6 qershor 2024, Kryetarja caktoi gjykatësen Masëlo si Gjykatëse të Procedurës Paraprake në Çështjen 12.¹¹

3. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi pjesërisht Aktakuzën kundër Thaçit dhe të akuzuarve të tjerë me të, z. Bashkim Smakaj ("Smakaj"), z. Isni Kilaj ("Kilaj"), z. Fadil Fazliu ("Fazliu") dhe z. Hajredin Kuçi ("Kuçi"), për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe rendit publik për ndërhyrje të pretenduar në Çështjen 06 para Trupit Gjykues II, në të cilën Thaçi është gjithashtu i akuzuar ("Vendimi i Konfirmimit").¹²

4. Më 14 prill 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ndryshoi Vendimin e Konfirmimit, urdhëroi ZPS-në të dorëzonte aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar dhe caktoi datën 8 maj 2025 si datë të dorëzimit të mocioneve paraprake të Mbrojtjes.¹³

⁹ KSC-BC-2020-06, F03216/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Materialeve në lidhje me Pengimin, 26 gusht 2025, (versioni konfidencial u dorëzua më 29 maj 2025) (Vendimi për Materialet në lidhje me Pengimin në Çështjen 06").

¹⁰ KSC-BC-2018-01, F00697/COR, Version i Korrigjuar i Vendimit për Caktimin e Gjykatëses së Vetme, 12 korrik 2024, (versioni i pakorrigjuar u dorëzua më 6 qershor 2024) (Vendimi për Caktimin e Gjykatëses së Vetme"). Paneli i Apelit vëren se gjykatësja Masëlo u caktua si Gjykatëse e Vetme për procedurat në kuadër të KSC-BC-2018-01 për të zëvendësuar gjykatësin Giju pas dorëheqjes së tij nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara ("Regjistri i Gjykatësve"). Shih Vendimin për Caktimin e Gjykatëses së Vetme, para. 3, Vendimi.

¹¹ F00015, Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Procedurës Paraprake, 6 qershor 2024, (konfidencial, riklasifikuar si publik më 11 dhjetor 2024) ("Vendimi për Caktimin e Gjykatëses së Procedurës Paraprake").

¹² F00036/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës, 12 shkurt 2025 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 29 nëntor 2024, dhe u riklasifikua si konfidencial më 13 dhjetor 2024) ("Vendimi i Konfirmimit").

¹³ F00260, Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmim e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake, 14 prill 2025, ("Vendimi për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake").

5. Më 16 prill 2025, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ("Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar").¹⁴

6. Më 7 maj 2025, Thaçi dorëzoi një mocion paraprak me të cilin kërkoi (i) shtyrjen e procesit gjyqësor të tij në Çështjen 12 deri në përfundim të procesit gjyqësor në Çështjen 06 dhe (ii) veçimin e akuzave ndaj tij në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar nga akuzat e ngritura kundër të akuzuarve të tjerë me të në Çështjen 12 ("Mocioni Paraprak i Thaçit për Shtyrje dhe Veçim të Procesit").¹⁵ Thaçi pretendoi, ndër të tjera, se: (i) mbajtja në të njëjtën kohë e dy gjykimeve do të rezultonte në konstatime përkuese dhe do të shkelte të drejtat për gjykim të drejtë të Mbrojtjes;¹⁶ dhe (ii) shtyrja e gjykimit në Çështjen 12 deri në përfundim të gjykimit në Çështjen 06 dhe veçimi i akuzave janë të domosdoshme për mbrojtjen e të drejtës së të akuzuarve të tjerë me të në Çështjen 12 për t'u gjykuar pa vonesa të paarsyeshme.¹⁷

7. Po të njëjtën ditë, ekipet e Mbrojtjes së Smakajt, Kilajt, Fazliut dhe Kuçit dorëzuan një mocion paraprak të përbashkët ("Mocioni Paraprak i Përbashkët për Shtyrje dhe Veçim të Procesit"), me të cilin mbështetën kërkesën e Thaçit për shtyrjen e procesit gjyqësor ndaj tij në Çështjen 12 deri në përfundimin e gjykimit në Çështjen 06, dhe kërkoi veçimin e akuzave kundër tij në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar në mënyrë që gjykimi i të bashkakuzuarve të tij të mund të vazhdonte në mënyrë të përsheptuar pa Thaçin, për të mbrojtur të drejtën e tyre për t'u gjykuar pa vonesë të paarsyeshme.¹⁸

¹⁴ F00264, Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar; F00264/A02, Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar, 16 prill 2025.

¹⁵ F00285, Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Thaçit për Veçimin e Akuzave dhe Shtyrjen e Procesit Gjyqësor për z. Thaçi, 7 maj 2025, ("Mocioni Paraprak i Thaçit për Shtyrje dhe Veçim të Procesit"), para. 1-3, 52-55, 59, 70, 75, 83. Shih gjithashtu Mocionin Paraprak të Thaçit për Shtyrje dhe Veçim të Procesit, para. 17-19.

¹⁶ Mocioni Paraprak i Thaçit për Shtyrje dhe Veçim të Procesit, para. 27, 33-55, 60-74.

¹⁷ Mocioni Paraprak i Thaçit për Shtyrje dhe Veçim të Procesit, para. 56-59, 75-82.

¹⁸ F00286, Mocion Paraprak i Përbashkët i Mbrojtjes sipas Rregullës 97 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 7 maj 2025, ("Mocioni Paraprak i Përbashkët i Mbrojtjes për Shtyrje dhe Veçim të Procesit"), para. 3, 10-23. Shih gjithashtu Mocionin Paraprak të Thaçit për Shtyrje dhe Veçim të Procesit, para. 76.

8. Më 8 maj 2025, Thaçi dorëzoi një mocion të dytë paraprak me të cilin kundërshtonte juridiksionin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake mbi bazën e dy pikave ("Mocioni Paraprak i Thaçit për Juridiksionin"), duke argumentuar se "juridiksionin ekskluziv për të gjitha aspektet e Çështjes 06", përfshirë në lidhje me shqyrtimin e pretendimeve për mosbindje ndaj gjykatës, e kishte Trupi Gjykses II e jo Gjykatësja e Procedurës Paraprake.¹⁹ Thaçi gjithashtu argumentoi se Kryetarja e kishte caktuar Gjykatësën e Procedurës Paraprake në shkelje të Ligjit, pasi e njëjta Gjykatëse e Procedurës Paraprake ishte caktuar më parë si Gjykatëse e Vetme për të njëjtën çështje.²⁰

9. Më 19 qershor 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin, me të cilin rrëzoi Mocionin Paraprak të Thaçit për Juridiksionin.²¹

10. Më 30 qershor 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin e Apeluar mbi Shtyrjen e Procesit, me të cilin rrëzoi Mocionin Paraprak të Thaçit për Shtyrje dhe Veçim të Procesit dhe Mocionin Paraprak të Përbashkët për Shtyrje dhe Veçim të Procesit.²²

11. Më 30 qershor 2025, Thaçi i dorëzoi Gjykatësës së Procedurës Paraprake një Kërkesë për Leje për Apelim të Vendimit mbi Juridiksionin ("Kërkesa për Leje për Apelim të Vendimit mbi Juridiksionin").²³

¹⁹ F00290/RED, Version i Redaktuar Publik i Mocionit Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit për Juridiksionin, 12 maj 2025, (versioni konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 8 maj 2025) ("Mocioni Paraprak i Thaçit për Juridiksionin"), para. 21-56.

²⁰ Mocioni i Paraprak i Thaçit për Juridiksionin, para. 57-81.

²¹ Vendimi i Apeluar mbi Juridiksionin, para. 42.

²² Vendimi i Apeluar mbi Shtyrjen e Procesit, para. 77.

²³ F00355/RED, Version i Redaktuar Publik i Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit për Juridiksionin, 4 korrik 2025, (versioni konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 30 qershor 2025) ("Kërkesa për Leje për Apelim të Vendimit mbi Juridiksionin"), para. 1-35.

12. Më 2 korrik 2025, Thaçi apeloj drejtpërdrejt edhe Vendimin për Juridiksionin në përputhje me nenin 45(2) të Ligjit, duke argumentuar se mocionet paraprake që kundërshtojnë juridiksionin e Dhomave të Specializuara parashtrohet mbi bazën e të drejtës së vetvetishme për apel dhe kërkoi që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të shtynte marrjen e vendimit mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit mbi Juridiksionin në pritje të vendimit të Panelit të Apelit ("Apeli i Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë").²⁴ Më 4 korrik 2025, ZPS-ja kërkoi që Paneli i Apelit të rrëzonte *in limine* Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë.²⁵ Më 4 gusht 2025, Paneli i Apelit konstatoi se Apeli i Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë ishte i papranueshëm në bazë të nenit 45(2) të Ligjit, pasi, ndër të tjera, pika e ngritur në apel nuk kishte të bënte *stricto sensu* me juridiksionin personal, territorial, kohor ose lëndor të Dhomave të Specializuara ("Vendimi i Apelit mbi Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë").²⁶

13. Më 23 korrik 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesën e Thaçit për shtyrjen e shqyrtimit të Kërkesës për Leje për Apelim të Vendimit mbi Juridiksionin dhe miratoi lejen për Apelim të Vendimit mbi Juridiksionin për tre prej katër pikave, si më poshtë:²⁷

²⁴ IA005/F00001/RED/COR, Version i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Apelit kundër Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit për Juridiksionin, 7 korrik 2025, (versioni i redaktuar publik i pakorrigjuar u dorëzua më 4 korrik 2025, versioni konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 2 korrik 2025) ("Apeli i Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë"), para. 1, 7, 12-19.

²⁵ IA005/F00003, Përgjigje e Prokurorisë në lidhje me Pranueshmërinë e Apelit të Thaçit kundër Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit për Juridiksionin, 4 korrik 2025, (konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar si publike më 4 gusht 2025), para. 1, 17(a).

²⁶ IA005/F00005, Vendimi mbi Pranueshmërinë e KSC-BC-2023-12/IA005/F00001, 4 gusht 2025 ("Vendim i Apelit mbi Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë"), para. 15-20, 28. Shih gjithashtu Vendimin e Apelit mbi Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë, para. 21-25. Paneli i Apelit kujton se në Vendimin e Apelit mbi Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë bëri të ditur se do të shqyrtonte, për aq sa ishte e mundshme, vetëm argumentet lidhur me aspektin specifik të pranueshmërisë në Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë, por jo themelësinë e atij Apeli. Shih Vendimin e Apelit mbi Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë, para. 5.

²⁷ F00391, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin Paraprak për Juridiksionin, 23 korrik 2025, ("Vendimi mbi Lejen për Apel për Juridiksionin"), para. 19-35.

- (a) nëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake bëri gabim ligjor sepse bëri interpretim të pasaktë të parimit *res judicata* ("pika e parë e autorizuar" ose "Pika 1");²⁸
- (b) nëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake bëri gabim ligjor që gjykoi se nuk mund të shqyrtojë ligjshmërinë e caktimit të saj, dhe dha arsye të pamjaftueshme për këtë ("pika e dytë e autorizuar" ose "Pika 2");²⁹ dhe
- (c) nëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake bëri gabim ligjor që konstatoi se rregulla 20 e Rregullores e ndalon Mbrojtjen të kundërshtojë, me anë të një mocioni paraprak, praktikën e emërimit të të njëjtit gjykatës edhe si Gjykatës i Vetëm, edhe si Gjykatës i Procedurës Paraprake, dhe dha arsye të pamjaftueshme për këtë ("pika e tretë e autorizuar" ose "Pika 3").³⁰

14. Më 8 korrik 2025, Thaçi dorëzoi një kërkesë ku kërkoi leje për të apeluar Vendimin për Shtyrjen e Procesit ("Kërkesa për Leje për Apel për Shtyrjen e Procesit").³¹

15. Më 23 korrik 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake miratoi Kërkesën për Leje për Apel për Shtyrjen e Procesit dhe autorizoi për apelim pikën e mëposhtme: "nëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake bëri interpretim të gabuar të parimit *res judicata* ("pika e autorizuar").³²

²⁸ Vendimi mbi Lejen për Apel për Juridiksionin, para. 27-30, 35.

²⁹ Vendimi mbi Lejen për Apel për Juridiksionin, para. 31-35.

³⁰ Vendimi mbi Lejen për Apel për Juridiksionin, para. 31-35.

³¹ F00367/RED, Version i Redaktuar Publik i Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit, 16 korrik 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 8 korrik 2025) ("Kërkesa për Leje për Apel për Shtyrjen e Procesit").

³² F00390/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje dhe Veçim të Procesit, 23 korrik 2025, (versioni konfidencial u dorëzua më 23 korrik 2025) ("Vendimi i Lejes për Apelim për Shtyrjen e Procesit"), para. 6, 22-23.

II. STANDARDI I SHQYRTIMIT

16. Paneli i Gjykatës së Apelit zbaton standardin e shqyrtimit për apelet e ndërmjetme të përcaktuar në vendimin e tij të parë dhe të zbatuar në vijimësi.³³

III. PARASHTRIME PUBLIKE

17. Paneli i Apelit vëren se Vendimi i Apeluar mbi Juridiksionin u dorëzua me klasifikimin si publik. Paneli vëren se Vendimi i Apeluar mbi Shtyrjen e Procesit u dorëzua fillimisht me klasifikimin si konfidencial, dhe se më pas u dorëzua versioni i redaktuar publik i tij. Paneli vëren gjithashtu se, ndonëse Thaçi fillimisht i dorëzoi Apelet me klasifikimin konfidencial dhe *ex parte*, më pas, më 20 gusht 2025, u dorëzuan versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik i Apeleve. Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit dhe Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin u dorëzuan me klasifikim konfidencial dhe *ex parte* në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, por palët vunë në dukje se këto parashtrime mund të riklasifikoheshin si publike, pasi nuk përmbanin informacion konfidencial.³⁴

18. Paneli rikujton se të gjitha parashtrimet e protokolluara para Dhomave të Specializuara duhet të jenë publike, përveç kur ka arsye të posaçme për t'i mbajtur konfidenciale, dhe se palët duhet të dorëzojnë për protokollim versione të redaktuara

³³ KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020, para. 14-14.

³⁴ IA006/F00006, Kërkesë e Prokurorisë për Riklasifikim të Parashtrimit IA006/F00005, 29 gusht 2025 (konfidenciale dhe *ex parte*) ("Kërkesa e ZPS-së për Riklasifikim"), para. 1; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 36; IA006/F00008, Kërkesë e Prokurorisë për Riklasifikim të Parashtrimit IA006/F00007, 16 tetor 2025 (konfidenciale dhe *ex parte*) ("Kërkesa e ZPS-së për Riklasifikim"), para. 1; Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 23; Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 24. Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se ZPS-ja dhe Thaçi, përkatësisht, nuk kundërshtojnë riklasifikimin si publike të Kërkesës së ZPS-së për Riklasifikim dhe të Kërkesës e Thaçit për Riklasifikim. Shih Kërkesën e Prokurorisë për Riklasifikim, para.2. Kërkesa e Thaçit për Riklasifikim, para. 2.

publike të të gjitha parashtrimeve që i paraqesin Panelit.³⁵ Rrjedhimisht, Paneli miraton Kërkesën e ZPS-së për Riklasifikim dhe Kërkesën e Thaçit për Riklasifikim si dhe urdhëron riklasifikimin si publike të Përgjigjes ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, Përgjigjes ndaj Apelit për Juridiksionin, Kundërpërgjigjes në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, Kundërpërgjigjes në kuadër të Apelit për Juridiksionin, Kërkesës së ZPS-së për Riklasifikim dhe Kërkesës së Thaçit për Riklasifikim.

IV. DISKUTIM

A. PRETENDIMI PËR MOSZBATIM TË SAKTË TË PARIMIT *RES JUDICATA* (PIKA 1)

19. Paraprakisht, Paneli i Apelit vëren se pika e parë e autorizuar lidhur me Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin dhe pika e autorizuar lidhur me Vendimin e Apeluar mbi Shtyrjen e Procesit, përkrijnë në masë të konsiderueshme dhe, rrjedhimisht, Paneli do t'i shqyrtojë ato pika bashkërisht në kuadër të "Pikës 1".

1. Parashtrimet e palëve

20. Thaçi parashtron se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se *res judicata* nuk zbatohet mes Çështjeve 06 dhe 12 mbi bazën se ato nuk janë e njëjta çështje, ato kanë të bëjnë me persona të akuzuar të ndryshëm, vepra penale të pretenduara të ndryshme dhe kuadër kohor të ndryshëm, dhe, për rrjedhojë, nuk ka si të ketë aspekte përkuese midis dy çështjeve.³⁶ Sipas Thaçit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake zbatoi në mënyrë të gabuar standardin e "çështjes së njëjtë" në kuadër të vendimit mbi zbatueshmërinë e *res judicata*,³⁷ dhe, rrjedhimisht, i keqinterpretoi

³⁵ Shih KSC-BC-2020-06, IA008/F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit), 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021), para.8-9. KSC-CA-2022-01, F00103, Vendim mbi Kërkesën e Gucatit për Riklasifikim ose Versione të Redaktuara Publike të Vendimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit, 9 janar 2023, para. 2.

³⁶ Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 20-23, 25-27, 30, 46. Apeli për Juridiksionin, para. 13-14, 18-23, 60.

³⁷ Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 22-23, 26, 30. Paneli vëren se në Apelin për Juridiksionin, Thaçi nuk i referohet konkretisht standardit të "çështjes së njëjtë", por argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake zbatoi një koncept të ngushtë të parimit *res judicata*, që kërkon që akuzat në dy çështjet gjyqësore të jenë të njëjta. Shih Apelin për Juridiksionin, para. 14.

kriteret e *res judicata*, të cilat janë më se të konsoliduara në jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare³⁸ dhe janë zbatuar në mënyrë të ngjashme nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.³⁹

21. Bazuar në këtë gabim, Thaçi argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake u përqendrua në mënyrë të gabuar në faktin se aktakuzat në Çështjen 06 dhe Çështjen 12 përfshijnë vepra penale të ndryshme, në vend që të vlerësonte nëse panelet gjyqësore përkatëse do të duhet të marrin vendime mbi ndonjë prej aspekteve që ishin të njëjta.⁴⁰ Sipas Mbrojtjes, Gjykatësja e Procedurës Paraprake duket se ngatërron parimin *res judicata* me doktrinën *non bis in idem*, duke kufizuar zbatimin e tij vetëm për "akuza të njëjta", kur në fakt çdo aspekt i përbashkët në dy vendime gjyqësore mund të aktivizojë parimin *res judicata*.⁴¹

22. Mbrojtja argumenton gjithashtu e kjo qasje është në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ") dhe të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të cilat i referohen vendimit përfundimtar të gjykatës për një "aspekt".⁴²

23. Sipas Thaçit, është e qartë se Çështja 06 dhe Çështja 12 kanë aspekte të njëjta,⁴³ çka bën të domosdoshëm jo vetëm veçimin e akuzave në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar dhe shtyrjen e procesit ndaj Thaçit deri në përfundim të procesit gjyqësor

³⁸ Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 22, 24. Apeli për Juridiksionin, para. 14-16.

³⁹ Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 24 ku citohet, Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ae. nr. 287/18 të 27 majit 2019 dhe Aktvendimit I.EK nr. 330/2019, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, të 1 gushtit 2019, KI 195/19, Aktgjykim, 31 maj 2021 ("Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i 31 majit 2021")*, para. 102.

⁴⁰ Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 22, 30; Apeli për Juridiksionin, para. 18. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 8.

⁴¹ Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 25, 31, 33-35; Apeli për Juridiksionin, para. 14-17 (theksimi në origjinal). Në këtë aspekt, Mbrojtja shton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk paraqet asnjë bazë ligjore në mbështetje të kësaj qasjeje. Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 23, 33. Kundërpërgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 8; Kundërpërgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 5.

⁴² Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 37; Apelin për Juridiksionin, para. 17. Në të dy apelet, Thaçi i referohet ECtHR, *Brumărescu v. Romania*, no. 28342/95, Judgment, 28 October 1999 ("*Brumărescu v. Romania* Judgment"), para. 61; Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i 31 majit 2021, para. 100.

⁴³ Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 38; Apelin për Juridiksionin, para. 11. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 10, 22.

në Çështjen 06,⁴⁴ por edhe rrëzimin e Aktakuzës në Çështjen 12.⁴⁵ Në këtë aspekt, Thaçi shpjegon se Trupi Gjykses II pranoi si prova në Çështjen 06 materiale të marra gjatë hetimeve lidhur me ndërhyrjen e pretenduar ndaj dëshmitarëve dhe konstatoi se ato ishin relevante për ekzistencën e "atmosferës së frikësimit" dhe besueshmërinë e dëshmitarëve.⁴⁶ Mbrojtja parashtron se nga Trupi Gjykses II "pritet të bëjë konstatime" në lidhje me aspektet e ndërhyrjes së pretenduar ndaj dëshmitarëve, që përbëjnë thelbin e akuzave në Çështjen 12.⁴⁷

24. Thaçi argumenton se ekziston rreziku real që, në qoftë se gjykimet në Çështjen 06 dhe Çështjen 12 mbahen paralelisht, panelet gjyqësore përkatëse do të bëjnë konstatime faktike të kundërta, në shkelje të së drejtës së Thaçit për qartësi juridike dhe prezumimit të pafajësisë së tij në Çështjen 12.⁴⁸ Në lidhje me këtë, Thaçi argumenton se, në qoftë se Gjykatësja e Procedurës Paraprake do ta kishte zbatuar saktë parimin *res judicata*, ajo do të kishte arritur në përfundimin se për respektimin e të drejtës për gjykim të drejtë të Thaçit, duhej që Trupi Gjykses II të mbante kontrollin mbi aspektet që janë bërë objekt i Çështjes 12.⁴⁹

25. Thaçi gjithashtu argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake "përfshiu në mënyrë të gabuar kriterin" që të gjitha palët në dy proceset gjyqësore duhet të jenë të njëjta, që parimi *res judicata* të zbatohet për ndonjë prej tyre.⁵⁰ Rrjedhimisht, Thaçi

⁴⁴ Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 44, 46, 48. Shih gjithashtu Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 12-13.

⁴⁵ Apeli për Juridiksionin, para. 21-23, 60.

⁴⁶ Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 14; Apeli për Juridiksionin, para. 11. Në të dy apelet Thaçi i referohet Vendimit mbi Materialet në lidhje me Pengimin e Procesit në Çështjen 06, para. 34-38.

⁴⁷ Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 15, 17, 38-39; Apeli për Juridiksionin, para. 11-12, 22. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 2; Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 2.

⁴⁸ Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 38-39, 43-44, 46; Apeli për Juridiksionin, para. 12, 22-23. Shih gjithashtu Apelin për Shtyrjen e Procesit para. 12-13; Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 3-4.

⁴⁹ Apeli për Juridiksionin, para. 21-22.

⁵⁰ Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 22, 26-29. Në Apelin për Shtyrjen e Procesit, Mbrojtja argumenton gjithashtu se jurisprudenca përkatëse e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ") mbështet më tej premisën se parimi *res judicata* mund të zbatohet në lidhje me disa, dhe jo me të gjitha palët në një çështje gjyqësore. Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 28.

parashtron se parimi *res judicata* aktivizohet në rastin e tij dhe të ZPS-së, që janë palë në të dy proceset gjyqësore, pavarësisht faktit se të bashkakuarit e tij në Çështjen 12 nuk janë palë në Çështjen 06.⁵¹

26. ZPS-ja përgjigjet se Apelet bazohen në "një interpretim rrënjësisht të gabuar" të parimit *res judicata* dhe duhet të rrëzohen.⁵² Konkretisht, ZPS-ja argumenton se nuk është përmbushur asnjë prej kushteve të parimit *res judicata*, pasi: (i) palët në Çështjen 12 dhe Çështjen 06 janë të ndryshme; (ii) akuzat janë juridikisht të ndryshme; dhe (iii) asnjë Panel tjetër nuk ka marrë ndonjë vendim përfundimtar mbi pretendimet e ngritura në Aktakuzën e Çështjes 12.⁵³ Sipas ZPS-së, interpretimi i Thaçit se parimi *res judicata* përfshin të gjitha konstatimet - dhe jo vetëm një për të cilin do të merret vendim përfundimtar në çështjen juridike nën shqyrtim - është në kundërshtim me zbatimin e zakonshëm dhe të duhur të tij.⁵⁴ ZPS-ja argumenton gjithashtu se në Apelet, Thaçi kërkon që Paneli i Apelit të kryejë një "analizë abstrakte dhe hipotetike" dhe të parashikojë konstatimet e ardhshme të Trupit Gjyqësor II, që nuk është as mënyra se si duhet të vlerësohet *res judicata*, e as funksioni i rishikimit prapaveprues në apel.⁵⁵

27. Si mbështetje, ZPS-ja argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk keqinterpretoi e as imponoi standardin e "çështjes së njëjtë", por përkundrazi artikuloi dhe zbatoi qartë standardin *res judicata*, dhe konstatoi saktë se ai ishte i pazbatueshëm.⁵⁶ Së pari, në lidhje me kriterin e "aspekteve të njëjta", ZPS-ja parashtron se këto dy çështje gjyqësore kanë kuadër lëndor të ndryshëm.⁵⁷ Sipas ZPS-së, parimi

⁵¹ Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 27, 29. Shih gjithashtu Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 18-19.

⁵² Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 1, 4, 6; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 1, 3, 6. Shih gjithashtu Përgjigjen ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 21.

⁵³ Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 2, 6, 29; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 2, 6, 22.

⁵⁴ Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 3, 6; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 3, 6.

⁵⁵ Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 4; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 3.

⁵⁶ Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 5, 28; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 5, 21.

⁵⁷ Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 14; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 8.

res judicata nuk përfshin të gjitha aspektet që mund të shqyrtohen në një vendim gjyqësor, por zbatohet vetëm për aspektet materiale që janë shqyrtuar plotësisht dhe për të cilat është marrë vendim në bazë të themelësisë së tyre,⁵⁸ e të cilat janë thelbësore për marrjen e vendimit në çështjen gjyqësore në shqyrtim.⁵⁹

28. Lidhur me kriterin e "palës së njëjtë", ZPS-ja parashtron se, ndonëse Thaçi është i bashkakuzuar në të dyja çështjet gjyqësore, personat e tjerë të akuzuar në Çështjen 06 dhe në Çështjen 12 janë të ndryshëm.⁶⁰ Në këtë aspekt, ZPS-ja parashtron se parimi *res judicata* zbatohet vetëm në procese gjyqësore ku janë të përfshirë të njëjtët persona,⁶¹ dhe interpretimi që i bëhet përgjithësisht këtij parimi është se ai nuk zbatohet njëkohësisht në dy çështje gjyqësore të ndryshme me shumë të akuzuar, ku palët nuk janë të gjitha të njëjta në të dy proceset.⁶²

29. ZPS-ja përgjigjet se, në lidhje me kriterin e "pakthyeshmërisë së vendimit", argumentet e Thaçit janë të parakohshme, pasi në Çështjen 06 nuk është marrë vendim përfundimtar, përfshirë në lidhje me ndonjë apel që do të aktivizonte *res judicata*.⁶³ Sipas ZPS-së, Thaçi bën supozime hipotetike se Trupi Gjykses II do të bëjë konstatime që lidhen me përgjegjësinë penale sipas akuzave në Çështjen 12.⁶⁴

30. Si përfundim, ZPS-ja rithekson se është legjitime që Trupi Gjykses II të marrë parasysh materialet në lidhje me pengimin për vlerësimin e besueshmërisë së

⁵⁸ Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 15; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 9.

⁵⁹ Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 15-18; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 9-12. Shih gjithashtu Përgjigjen ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 19; Përgjigjen ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 13. Të dyja përgjigjet i referohen ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-3029, Decision on "Prosecution's Application to Submit Additional Evidence", 2 April 2014 ("*Bemba* Additional Evidence Decision"), paras 26-31.

⁶⁰ Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 7; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 7.

⁶¹ Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 7; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 7. Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 7-13; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 7.

Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 22-23; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 15-16.

Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 24-27; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 17-20.

dëshmitarëve dhe atmosferës së ndërhyrjes, dhe kjo nuk do të përbënte "shqyrtim gjyqësor të aspekteve paralelisht",⁶⁵ e as nuk do të shkelte prezumimin e pafajësisë së Thaçit në Çështjen 12.⁶⁶ Përkundrazi, ZPS-ja argumenton se aktakuza në Çështjen 06 e kufizon vendimmarrjen e Trupit Gjyqësor II vetëm në kuadrin e pretendimeve të përfshira në të dhe, duke qenë se në secilën çështje gjyqësore duhet të merren vendime për vepra penale të ndryshme, nuk ka gjasë që në Çështjen 12 të aktivizohet parimi *res judicata*.⁶⁷

31. Pavarësisht nga kjo, ZPS-ja parashtron se, edhe nëse Trupi Gjyqësor II do të bënte konstatime të tilla, ato nuk do të ishin thelbësore për vendimin në Çështjen 06 dhe, rrjedhimisht, nuk aktivizojnë parimin *res judicata*.⁶⁸

32. Në kundërpërgjigje Thaçi sqaron se ai nuk argumenton se parimi *res judicata* aktivizohet që tani, por se ekziston mundësia e konstatimeve faktike kontradiktore që në të ardhmen do të kenë efekt *res judicata* mbi Thaçin në Çështjen 12.⁶⁹ Lidhur me kriterin e "aspekteve të njëjta", Mbrojtja parashtron se, ndonëse pajtohet me ZPS-në se një aspekt duhet të jetë debatuar juridikisht dhe të jetë marrë vendim për të, në asnjë burim ligjor në jurisprudencën e të drejtës penale ndërkombëtare nuk bëhet dallim

⁶⁵ Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 20; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 13.

⁶⁶ Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 13. Lidhur me këtë, ZPS-ja parashtron se Thaçi keqinterpretonte arsyet për të cilat Trupi Gjyqësor II pranoi materialet që kanë të bëjnë me pengimin e procesit, për të cilat ai theksoi qartë se do të shqyrtohen vetëm në kuadër të vlerësimit të besueshmërisë së dëshmitarëve dhe atmosferës së frikësimit. Shih Përgjigjen ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 24-25; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 17-18.

⁶⁷ Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 21; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 14.

⁶⁸ Përgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 26; Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 19.

⁶⁹ Kundërpërgjigjja ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 1-3; Kundërpërgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 1-2. Në Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, Mbrojtja thekson se, duke pasur parasysh ecurinë e deritanishme në Çështjen 12, shtyrja e procesit është e domosdoshme për të shmangur pasojat negative që do të shkaktonte gjykimi i njëkohshëm i dy çështjeve gjyqësore të lidhura me njëra-tjetrën. Shih Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 4.

midis aspekteve "thelbësore" dhe të tjerave në këtë kontekst.⁷⁰ Sipas Thaçit, çdo konstatim faktik në një aktgjykim është "thelbësor" në qoftë se ndikon në verdiktin për cilëndo akuzë.⁷¹ Lidhur me kriterin e "palëve të njëjta", Thaçi kundërpërgjigjet se argumenti i ZPS-së se parimi *res judicata* kërkon që të gjitha palët të jenë të njëjta, është i pambështetur dhe i pabazë.⁷²

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

33. Në Vendimet e Apeluara, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se parimi i *res judicata* nuk aktivizohet në këto procese gjyqësore sepse: (i) Çështja 06 dhe Çështja 12 "kanë të bëjnë me persona të akuzuar të ndryshëm, vepra penale të pretenduara të ndryshme dhe kuadër kohor të ndryshëm"; (ii) çfarëdo konstatimesh në lidhje me akuzat në dy çështjet gjyqësore janë krejtësisht të ndryshme dhe panelet i kryejnë procedimet dhe vlerësimet e tyre në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri; (iii) thelbi i akuzave në Çështjen 12 nuk ka të bëjë me pretendimin për ndërhyrje ndaj dëshmitarëve në vetvete, por me "tentativën për pengim me synim shkaktimin e një ndërhyrjeje të tillë"; dhe (iv) Trupi Gjykues II do të kryejë vlerësimet e veta të besueshmërisë së dëshmitarëve në Çështjen 06 dhe do të përcaktojë më vete ndikimin e ndërhyrjes së pretenduar, bazuar në provat që i janë paraqitur.⁷³

34. Fillimisht, Paneli i Gjykatës së Apelit vëren se *res judicata* është parim i përgjithshëm sipas të cilit një aktgjykim i dhënë nga një autoritet gjyqësor, ka fuqi

⁷⁰ Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 7; Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 4.

⁷¹ Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 7; Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 4. Në Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, Mbrojtja parashtroi gjithashtu se vendimet e cituara në Apelin për Shtyrjen e Procesit janë raste në të cilët u konstatua se *res judicata* nuk zbatohet për arsye të dallueshme, që mbështet përfundimin se aktgjykimi në Çështjen 06 do të ketë ndikim *res judicata* në Çështjen 12. Mbrojtja argumenton gjithashtu se vendimi i Dhomës së Gjykatës Supreme i Dhomave të Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias në Çështjen 002 tregon se *res judicata* mund të zbatohet për konstatime faktike, përfshirë në kontekstin e akuzave të ndryshme. Shih Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 9-16.

⁷² Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 17-21; Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 6-8.

⁷³ Shih Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin, para. 32, 34; Vendimi i Apeluar mbi Shtyrjen e Procesit, para. 58-59.

detyruese për palët në një kontest ligjor.⁷⁴ Paneli gjithashtu vëren se në mënyrë që të zbatohet parimi *res judicata* midis dy çështjeve gjyqësore, janë të domosdoshme tre kritere të përgjithshme si më poshtë: (i) palët të jenë të njëjta, (ii) aspektet të jenë të njëjta, dhe (iii) të jetë marrë më parë vendim përfundimtar për ato aspekte nga gjykata kompetente për marrjen e vendimit në lidhje me to.⁷⁵ Paneli thekson se duke mos u lejuar palëve të rihapin debate juridike për vendimet përfundimtare, përveçse në rrethana të posaçme,⁷⁶ doktrina *res judicata* shërben për të siguruar qartësi juridike⁷⁷ dhe për të mbrojtur pakthyeshmërinë e vendimeve gjyqësore dhe efektshmërinë e procesit gjyqësor.⁷⁸

(a) Aspekte të njëjta

35. Paneli së pari do të trajtojë argumentin e Thaçit se nuk është e nevojshme që akuzat në Çështjen 06 dhe Çështjen 12 të jenë të njëjta, por që çdo aspekt i përbashkët

⁷⁴ ICJ, *Effect of Awards of Compensation Made by the United Nations Administrative Tribunal*, Advisory Opinion, ICJ Reports 1954 (p. 47), 13 July 1954, p. 53.

⁷⁵ IRMCT, *Prosecutor v. Uwinkindi*, MICT-12-25-AR14.1, Decision on an Appeal Concerning a Request for Revocation of a Referral, 4 October 2016 (“*Uwinkindi* Appeal Decision”), para. 29; ICC, *Prosecutor v. Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-02/12-271-Corr, Judgment on the Prosecutor’s appeal against the decision of Trial Chamber II entitled “Judgment pursuant to article 74 of the Statute”, 7 April 2015 (“*Ngudjolo* Appeal Judgment”), para. 246; ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-T, Judgement, 16 November 1998 (“*Delalić et al.* Aktgjykimi, para. 228; ICTR, *Kajelijeli v. Prosecutor*, ICTR-98-44A-A, Judgment, 23 May 2005 (“*Kajelijeli* Appeal Judgement”), para. 202. Shih gjithashtu ECtHR, *Ryabykh v. Russia*, no. 52854/99, Judgment, 24 July 2003 (“*Ryabykh v. Russia* Judgment”), para. 52.

⁷⁶ ECtHR, *Ponomaryov v. Ukraine*, no. 3236/03, Judgment, 3 April 2018, para. 40; ECtHR, *Trapeznikov and Others v. Russia*, nos. 5623/09, 12460/09, 33656/09 and 20758/10, Judgment, 5 April 2016, para. 23; *Ryabykh v. Russia* Judgment, para. 52. Shih gjithashtu ECCC, *Co-Prosecutors v. Samphân*, 002/19-09-2007-ECCC/SC, Appeal Judgment, 23 December 2022, paras 634-635; *Kajelijeli* Appeal Judgement, para. 202.

⁷⁷ *Brumărescu v. Romania* Judgment, paras 61-62; IRMCT, *Prosecutor v. Karadžić*, MICT-13-55-A, Decision on a Motion for Redacted Versions of Decisions Issued under Rule 75(H) of the ICTY Rules, 18 July 2016, p. 4.

⁷⁸ Shih ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-568, Judgment on the Prosecutor's appeal against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "Decision Establishing General Principles Governing Applications to Restrict Disclosure pursuant to Rule 81 (2) and (4) of the Rules of Procedure and Evidence", 13 October 2006, Dissenting Opinion of Judge Pikis (“*Lubanga* Dissenting Opinion”), para. 16. Shih gjithashtu Ambos, K., *Treatise on International Criminal Law: Volume I: Foundations and General Part* (Second Edition), Oxford University Press 2021, Chapter VIII, D.(2)(a) (National *ne bis in idem*), p. 519; Ambos, K., *Treatise on International Criminal Law: Volume III: International Criminal Procedure* (Second Edition), Oxford University Press 2025, Chapter I, D.(3)(j) (*Ne bis in idem* (double jeopardy rule)), pp. 93-94.

i të dy vendimeve mund të aktivizojë parimin *res judicata*.⁷⁹ Sipas Thaçit, konstatimi i Gjykatës së Procedurës Paraprake se *res judicata* nuk zbatohet sepse dy çështjet gjyqësore kanë të bëjnë me "shkelje/vepra penale të pretenduara të ndryshme dhe kuadër kohor të ndryshëm", pasqyron keqinterpretimin prej saj të kritereve, pasi është e qartë se jo vetëm *akuzat*, por edhe çdo *aspekt* i përbashkët në dy vendime mund të aktivizojë *res judicata*.⁸⁰

36. Fillimisht, Paneli pajtohet me argumentin e Thaçit se njëjtësia e *aspekteve* është relevante për të përcaktuar nëse aktivizohet parimi *res judicata* mes dy çështjeve.⁸¹ Para se të trajtojë thelbin e argumentit të Thaçit, Paneli konstaton se në këtë rast është e rëndësishme të theksohet dallimi midis një akuze dhe një *aspekti* pasi, sipas Panelit, vlerësimi lidhur vetëm me nëse ekzistojnë apo jo akuza të përbashkëta midis dy çështjeve gjyqësore, do të kufizonte padrejtësisht fushëveprimin e parimit *res judicata*. Në këtë aspekt, Paneli vëren se termi *akuzë* duhet të interpretohet si "akuzë zyrtare për" një krim, "si hap paraprak drejt ndjekjes penale".⁸² *Aspekti*, nga ana tjetër, është koncept më i gjerë. Ai "nuk është thjesht diçka për të cilën ka mospajtim ose mendime të papajtueshme", por ka të bëjë me "një temë, zgjidhja e së cilës është thelbësore për

⁷⁹ Shih Apelin për Juridiksionin, para. 14-17; Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 33-37. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 5; Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 9, 15.

⁸⁰ Apeli për Juridiksionin, para. 15; Apeli për Shtyrjen e Procesit, para. 30-33.

⁸¹ Shih më lart, para. 34.

⁸² Garner, Bryan A. (ed.), *Black's Law Dictionary*, Thomson Reuters 2019 (11th ed.), p. 291. Shih gjithashtu KSC-CA-2024-03, F00069/RED, Versioni i redaktuar publik i Aktgjykimit të Apelit, 14 korrik 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 14 korrik 2025) ("Aktgjykimi i Apelit *Shala*,"), para. 194 (ku theksohet se një pikë ose akuzë e paraqitur në aktakuzë është "cilësimi ligjor i fakteve materiale që mbështesin pikën ose akuzën përkatëse në aktakuzë"); KSC-CC-2019-05, F00012, Vendim mbi Referimin e Mahir Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 dhjetorit 2018, 20 shkurt 2019, para. 29-31; KSC-BC-2020-06, IA030/F00009, Vendim mbi Apelet e Krasniqit dhe Selimit kundër Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 31 maj 2024, para. 19-20 (në të dy vendimet theksohet se GJEDNJ-ja ka konfirmuar se 'akuza penale' ekziston nga momenti kur personi njoftohet zyrtarisht nga organi kompetent për pretendimin se ka kryer veprë penale, ose kur "situata e tij ose e saj është ndikuar në mënyrë të konsiderueshme nga veprimet e ndërmarra prej autoriteteve" mbi bazën e dyshimit).

marrjen e vendimit në lidhje me aspekte që dalin në çështjen gjyqësore nën shqyrtim".⁸³

37. Duke dhënë sqarime të mëtejshme mbi kriterin e "aspekteve të njëjta", Gjykata Kushtetuese e Kosovës është shprehur se, për aktivizimin e parimit *res judicata*, rrethanat e çështjes duhet të jenë në thelb të njëjta dhe kyçe për vendimin, dhe aspektet duhet të jenë "thelbësore" për marrjen e vendimit.⁸⁴ Si mbështetje shtesë, Paneli vë në dukje jurisprudencë nga tribunale *ad hoc* dhe konstaton se *res judicata* ndalon që palët e njëjta të rihapin debate juridike "për të njëjtat aspekte dhe mbi baza në thelb të njëjta", duke iu referuar aspekteve që janë shqyrtuar në mënyrë të plotë dhe për të cilat është vendosur bazuar në themelësinë e tyre.⁸⁵ Kjo qasje është në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së.⁸⁶

38. Sa i përket argumentit të Thaçit se GJEDNJ-ja konstatoi se *res judicata* zbatohet për "çdo aspekt për të cilin është marrë vendim përfundimtar",⁸⁷ Paneli vëren se, ndonëse në çështjen *Brumaresku k. Rumanisë* GJEDNJ-ja iu referua zbatimit të *res*

⁸³ Paneli pranon se përkufizimi i "aspektit" i shprehur këtu nuk është dhënë në lidhje me analizën e parimit *res judicata*, por konstaton se është relevant pavarësisht nga konteksti specifik në të cilin është bërë. Për citimin e plotë dhe kontekst, shih *Lubanga* Dissenting Opinion, para. 22, që i referohet ICC, *Situation in the Democratic Republic of the Congo*, ICC-01/04-168, Judgment on the Prosecutor's Application for Extraordinary Review of Pre-Trial Chamber I's 31 March 2006 Decision Denying Leave to Appeal, 13 July 2006, para. 9.

⁸⁴ Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të 31 majit 2021, para. 115, 117-118, 125, 133.

⁸⁵ Shih *Delalić et al.* Trial Judgment, para. 228; Apelit *Kajelijeli* Appeal Judgment para. 202. Shih gjithashtu ICTR, *Prosecutor v. Karemera et al.*, ICTR-98-44-T, Decision on Joseph Nzirorera's Application for Certification to Appeal the Decision Denying his Motion to Admit Testimony of Elizaphan Ntakirutimana, 24 March 2009, para. 14.

⁸⁶ Shih *Brumărescu v. Romania* Judgment, para. 61; ECtHR, *Poghosyan v. Armenia*, no. 62356/09, Judgment, 31 March 2016, para. 44; ECtHR, *Şamat v. Turkey*, no. 29115/07, Judgment, 21 January 2020, para. 53.

⁸⁷ Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 37; Apelin për Juridiksionin, para. 17. Në të dy apelet Thaçi citon në veçanti to *Brumărescu v. Romania* Judgment, para. 61. Thaçi citon gjithashtu Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të 31 majit 2021, para. 100. Paneli vë në dukje se edhe ky aktgjykim mbështetet në jurisprudencën e çështjes *Brumaresku k. Rumanisë*. Gjithashtu, në përfundimin e këtij aktgjykimi shihet qartë se Gjykata Kushtetuese e Kosovës interpretoi se jurisprudenca e GJEDNJ-së zbatohet për "vendimet e plotfuqishme dhe detyruese gjyqësore" dhe jo për "çdo aspekt për të cilin është vendosur përfundimisht", siç pretendon Thaçi. Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të 31 majit 2021, para. 132.

judicata kur gjykatat "kanë dhënë vendim përfundimtar për një aspekt",⁸⁸ kjo referencë duhet parë në kontekstin e rrethanave konkrete të çështjes, ku GJEDNJ-ja në fakt iu referua jo çfarëdo aspekti, por "një vendimi gjyqësor" që ishte "i pakthyeshem" dhe që, për më tepër, ishte zbatuar.⁸⁹ Sipas Panelit, ndonëse Thaçi duket se fokusohet në "çdo aspekt", çka ishte përcaktuese në çështjen *Brumăresku k. Rumanisë* ishte se aspekti ishte juridikisht thelbësor (vendim gjyqësor) dhe ishte debatuar plotësisht në gjykim.⁹⁰

39. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se *res judicata* nuk përfshin që të gjitha aspektet që mund të shqyrtohen në një vendim gjyqësor, por vetëm aspektet materiale që janë debatuar plotësisht dhe për të cilat është vendosur në bazë të themelësisë së tyre, dhe të cilat janë thelbësore për marrjen e vendimit për aspektin në fjalë.⁹¹

40. Lidhur me aspektin nëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi që u përqendrua në *akuzat* e jo në *aspektet thelbësore për marrjen e vendimit*, në kundërshtim me argumentin e Thaçit,⁹² shqyrtimi i konstatimeve të Gjykatësës së Procedurës Paraprake tregon qartë se ajo ishte në dijeni të standardit të zbatueshem. Konkretisht, ajo konstatoi se pranimi i materialeve në lidhje me pengimin për qëllimet e autorizuara nga Trupi Gjykes II (vlerësimi i besueshmërisë së dëshmitarëve dhe ekzistenca e atmosferës së frikësimit të dëshmitarëve), "nuk krijonte përkim të aspekteve midis dy çështjeve gjyqësore", pasi secili Trup Gjykes shqyrton "aspekte të ndryshme dhe të dallueshme".⁹³ Pasi nuk ka konstatuar gabim në argumentet e Gjykatësës së Procedurës Paraprake, Paneli nuk ka nevojë të trajtojë argumentin e Thaçit lidhur me to se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duket se ngatërron *res*

⁸⁸ Shih *Brumărescu v. Romania* Judgment, para. 61.

⁸⁹ Shih *Brumărescu v. Romania* Judgment, para. 62.

⁹⁰ Shih *Brumărescu v. Romania* Judgment, para. 62.

⁹¹ Shih më lart, para. 37.

⁹² Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para.22, 25, 30-31, 33-34; Apelin për Juridiksionin, para. 14-18. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 8.

⁹³ Vendimi i Apeluar mbi Shtyrjen e Procesit, para. 59.

judicata me doktrinën *non bis in idem*, duke e kufizuar zbatimin e tij vetëm për "akuzat e njëjta".⁹⁴

41. Lidhur me aspektin nëse provat në materialet në lidhje me pengimin plotësojnë kriteret për t'u cilësuar si "aspekte të njëjta" në Çështjen 06 dhe Çështjen 12 në kuadër të standardit *res judicata*, Paneli vëren se Thaçi përmend "aspekte të tilla si nëse z. Thaçi zbuloi informacion konfidencial".⁹⁵ Ai argumenton se këto aspekte, përfshirë atë që Thaçi u dha "informacion dhe udhëzime" palëve të treta të paautorizuara, lidhen me pretendime kyçe në Çështjen 12, si edhe se Trupi Gjykses II ka shprehur gatishmërinë që të marrë vendim mbi këto aspekte në Çështjen 06.⁹⁶

42. Fillimisht, Paneli konstaton se pretendimi i Thaçit se Trupi Gjykses II ka shprehur gatishmërinë për të vendosur për këto aspekte në Çështjen 06, keqinterpreton konstatimet përkatëse. Paneli vëren se Trupi Gjykses II pranoi si prova materialet në lidhje me pengimin për qëllimin e vetëm të vlerësimit të besueshmërisë së dëshmitarëve dhe ekzistencës së atmosferës së përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve.⁹⁷ Paneli gjithashtu vëren se, kur pranoi si prova materialet në lidhje me pengimin, Trupi Gjykses II theksoi veçanërisht se nuk do të bënte vlerësime ose deduksione nëse këto materiale demonstrojnë sjellje penale të Thaçit sipas kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara, si dhe bëri të qartë se çfarëdo deduksioni tjetër lidhur me përgjegjësinë penale të Thaçit për aspekte që dalin nga këto materiale, nuk do të ishte prerogativë e Trupit Gjykses II.⁹⁸ Gjithashtu, Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses II refuzoi të pranonte materialet në lidhje me pengimin për vlerësimin e

⁹⁴ Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 25, 33-34; Apelin për Juridiksionin, para. 14-15.

⁹⁵ Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 38.

⁹⁶ Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 38-39, që i referohet Vendimit mbi Materialet në lidhje me Pengimin në Çështjen 06, para. 36-38; Apeli për Juridiksionin, para. 10-12, 18, 22-23. Shih gjithashtu Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 14-17.

⁹⁷ Vendimi për Materialet në lidhje me Pengimin në Çështjen 06, para. 36-38, 65, 72(c).

⁹⁸ Vendimi për Materialet në lidhje me Pengimin në Çështjen 06, para. 35. Shih gjithashtu Vendimin e Apeluar mbi Shtyrjen e Procesit, para. 59. Paneli i Apelit vëren se, sidoqoftë, sipas nenit 33(5) të Ligjit, Trupi Gjykses II nuk mund të shqyrtojë asnjë aspekt që ka të bëjë me shkelje të nenit 15(2) të Ligjit në kuadër të Çështjes 06.

ndonjë dënimi të mundshëm, duke konstatuar se kjo do të ishte e papërshtatshme pasi "do të kërkonte që Paneli të bënte vlerësim që lidhet me thelbin e akuzave penale që do të gjykohen në Çështjen 12".⁹⁹ Duke pasur parasysh këtë, Paneli pajtohet me konstatimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake se ky "është tregues i fortë se edhe Trupi Gjykses II gjykon se Çështja 06 është e ndarë dhe e pavarur nga çështja aktuale".¹⁰⁰

43. Mbrojtja pranon se aspektet e apeluara janë relevante në mënyra të ndryshme në dy çështjet gjyqësore.¹⁰¹ Në Çështjen 12, për këto aspekte duhet të merret vendim për të vlerësuar përgjegjësinë penale individuale e Thaçit për disa vepra penale të pretenduara. Në Çështjen 06, Trupi Gjykses II vendosi se i konsideron ato relevante për besueshmërinë e dëshmitarëve, mbështetshmërinë e provave dhe ekzistencën e atmosferës së frikësimit të dëshmitarëve që rrethon procesin. Megjithatë, sipas Thaçit, kjo nuk ndryshon faktin se aspektet faktike në fjalë janë të përbashkëta midis dy proceseve.¹⁰²

44. Paneli pajtohet se disa aspekte faktike janë të përbashkëta midis dy proceseve. Megjithatë, përkimi i fakteve midis dy gjykimeve nuk aktivizon *res judicata*, përveç nëse demonstron se aspektet relevante janë aspekte materiale që janë debatuar plotësisht dhe për themelësinë e të cilave është dhënë vendim, dhe se ato janë thelbësore për marrjen e vendimit në çështjen gjyqësore.¹⁰³ Bazuar në sa më lart, Paneli

⁹⁹ Vendimi për Materialet në lidhje me Pengimin në Çështjen 06, para. 40. Shih gjithashtu Vendimin e Apeluar mbi Shtyrjen e Procesit, para. 59. Paneli i Apelit vëren se, në lidhje me "përpjekjen e ZPS-së për të nxjerrë përfundimin se gjendja mendore e z. Thaçi në Çështjen 12 provon synimin kriminal të nevojshëm ligjrisht në këtë çështje", Trupi Gjykses II ritheksoi gjithashtu se nuk do të bënte "në këtë çështje vlerësime që hyjnë në sferën e një çështjeje të cilën nuk është ngarkuar ta shqyrtojë". Shih Vendimin për Materialet në lidhje me Pengimin në Çështjen 06, para. 39.

¹⁰⁰ Shih Vendimin e Apeluar mbi Shtyrjen e Procesit, para. 59. Shih gjithashtu Vendimin e Apeluar mbi Shtyrjen e Procesit, para. 60.

¹⁰¹ Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 40.

¹⁰² Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 40.

¹⁰³ Shih më lart, para. 37. Paneli vëren se në Çështjen *Bemba* në Gjykatën Penale Ndërkombëtare, ku kishte përkim midis një çështjeje gjyqësore kryesore dhe një procesi tjetër të lidhur me të për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, Trupi Gjykses konstatoi se materialet në lidhje me pengimin

konstaton se aspektet në Çështjet 06 dhe 12 nuk janë të njëjta që të aktivizojnë parimin *res judicata* dhe rrëzon kundërshtimet e Thaçit në lidhje me këtë.

(b) Ekzistenca e vendimit përfundimtar mbi aspektet

45. Paneli në vijim do të trajtojë kriterin e *res judicata* se duhet të ketë një vendim përfundimtar mbi aspektet relevante nga një gjykatë kompetente për marrjen e vendimit për to.¹⁰⁴ Paneli vëren se është parim i pranuar gjerësisht se, për aktivizimin e *res judicata*, duhet të ketë një vendim përfundimtar mbi themelësinë e aspekteve në fjalë në dy çështjet gjyqësore.¹⁰⁵ Paneli vëren se as në Çështjen 06, as në Çështjen 12, nuk ka aktgjykim të formës së prerë dhe, rrjedhimisht, ky kriter nuk përmbushet.

46. Paneli vëren se, në kundërpërgjigje ndaj argumenteve të ZPS-së, Thaçi pranon se *res judicata* ende nuk ngrihet për diskutim në këtë fazë të procesit, por parashtron se ekziston mundësia për ndikim të *ardhshëm* në Çështjen 12.¹⁰⁶ Paneli pranon se, në qoftë se procesi në Çështjen 12 nuk shtyhet, Thaçi nuk do të ketë mundësi të ngrejë argumentin *res judicata* në rast të konstatimeve mospërputhëse midis Çështjes 06 dhe Çështjes 12, në qoftë se kuvendimet gjyqësore në këto çështje do të zhvillohen paralelisht.¹⁰⁷ Sidoqoftë, duke marrë parasysh konstatimin e tij të mësipërm se

e procesit të dorëzuar nga prokuroria për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve nuk ishin "të domosdoshme për të vendosur mbi vërtetësinë e akuzave" në çështjen kryesore. Shih *Bemba* Additional Evidence Decision, para. 30. Në Çështjen *Lukiq dhe Lukiq*, Dhoma e Apelit e TPNJ-së konstatoi se, megjithëse Trupi Gjykoës gjykoësi se provat për ofrim parash ishin të pamjaftueshme për një gjykim më vete për mosbindje ndaj gjykatës, "ishte në diskrecionin e tij që t'i merrte parasysh këto prova në kuadër të vlerësimit të besueshmërisë [së dëshmitarëve në çështjen kryesore]". Shih ICTY, *Prosecutor v. Lukić and Lukić*, IT-98-32/1-A, Judgment, 4 December 2012, para. 77-79.

¹⁰⁴ Shih më lart, para. 34.

¹⁰⁵ Shih *Kajelijeli* Appeal Judgment, para. 202. Shih gjithashtu ECtHR, *Sergey Zolotukhin v. Russia*, no. 14939/03, Judgment, 10 February 2009, para. 107-108. Shih *Ngudjolo* Appeal Judgment, para. 246; *Uwinkindi* Appeal Decision, para. 29; *Ryabykh v. Russia* Judgment, para. 52; ICJ, *Application of the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide (Bosnia and Herzegovina v. Serbia and Montenegro)*, ICJ Reports 2007 (p. 43), Judgment, 26 February 2007, para. 138; STL, *Prosecutor v. El Sayed*, CH/AC/2012/03, Decision on the Prosecution's Partial Appeal of the Pre-Trial Judge's Order of 20 February 2012, 18 April 2012, para. 19.

¹⁰⁶ Shih Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 1-2 (theksimi i shtuar); Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 1-2 (theksimi i shtuar). Shih Vendimin mbi Lejen për Shtyrjen e Procesit, para. 20; Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit, para. 4.

aspektet për të cilat do të merret vendim në Çështjen 06 dhe Çështjen 12 nuk janë të njëjta dhe, për më tepër, se Trupi Gjykses II theksoi se nuk do të bënte konstatime mbi sjelljen penale të pretenduar të Thaçit në Çështjen 12, Paneli është i mendimit se nuk do të ketë aktivizim të *res judicata* mes Çështjes 06 dhe Çështjes 12. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se, bazuar në këta faktorë dhe në mungesën e aktgjykimit të formës së prerë në të dyja çështjet gjyqësore, Thaçi nuk ka demonstruar gabim në zbatimin e *res judicata* nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake.

47. Paneli vëren se për aktivizimin e *res judicata*, duhet të jenë të pranishëm bashkërisht të tre elementët – palët e njëjta, aspektet e njëjta dhe ekzistenca e vendimit përfundimtar për aspektet; ose, me fjalë të tjera, në qoftë se nuk përmbushet një prej kriterëve, *res judicata* mes dy çështjeve nuk aktivizohet.¹⁰⁸ Duke pasur parasysh se Paneli nuk ka konstatuar gabim në përfundimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake se midis çështjeve 06 dhe 12 nuk ka aspekte të njëjta apo vendime përfundimtare për to, pretendimet e Thaçit për gabime në lidhje me kriterin e "palës së njëjtë",¹⁰⁹ nuk ka nevojë të trajtohen. Paneli gjykon se çfarëdo konstatimesh të Panelit mbi këto argumente nuk do të kenë ndikim në rezultatin e Vendimeve të Apeluara.

48. Po kështu, argumentet e Thaçit në lidhje me dëmin që pretendon se i është shkaktuar si rezultat i moszbatimit të *res judicata* prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake në këtë proces,¹¹⁰ janë të tejkaluara. Si përfundim, Paneli i Apelit rikujton se kur i akuzuari pretendon shkelje të të drejtave për gjykim të drejtë, ai duhet të demonstrojë se ka pësuar dëm faktik nga shkelja, që i kufizon ndjeshëm të drejtën për mbrojtje të efektshme, dhe jo thjesht të ngrejë pretendime hamendësuese ose hipotetike se rrezikohet të dëmtohet.¹¹¹

¹⁰⁸ Shih, p.sh., *Uwinkindi Appeal Decision*, para. 29. Shih gjithashtu më lart, para. 34.

¹⁰⁹ Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 22, 26-29.

¹¹⁰ Shih Apelin për Shtyrjen e Procesit, para. 43-44, 46; Apelin për Juridiksionin, para. 10, 21-23.

¹¹¹ Shih KSC-BC-2020-04, IA001/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit lidhur me Lirimimin e Përkohshëm, 20 gusht 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 20 gusht 2021), para. 17.

49. Për rrjedhojë, Paneli i Apelit konstaton se Thaçi nuk ka demonstruar se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi duke interpretuar pasaktësisht zbatueshmërinë e parimit *res judicata* mes proceseve në Çështjet 06 dhe 12. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 1 të Apeleve.

B. PRETENDIMET PËR GABIME NË VLERËSIMIN E LIGJSHMËRISË SË CAKTIMIT TË GJYKATËSES SË PROCEDURËS PARAPRAKE DHE ZBATUESHMËRISË SË RREGULLËS 20 TË RREGULLORES (PIKAT 2 DHE 3)

1. Parashtrimet e palëve

50. Thaçi fillimisht argumenton se caktimi prej Kryetares i gjykatës Masëlo edhe si Gjykatëse e Vetme për të gjitha aspektet hetimore para ngritjes së aktakuzës, edhe si Gjykatëse e Procedurës Paraprake, ishte në shkelje të nenit 33 të Ligjit.¹¹² Thaçi parashtron se Gjykatësja e Procedurës Paraprake refuzoi të merrte vendim mbi themelësinë e këtyre argumenteve "duke dhënë dy arsye për refuzimin", që trajtohen në Pikën 2 dhe Pikën 3 të Apelit për Juridiksionin.¹¹³

51. Në Pikën 2, Thaçi argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se nuk mund të rishikonte ligjshmërinë e caktimit të saj, që, sipas Thaçit, përfshin dy gabime.¹¹⁴ Gabimi i parë, sipas tij, është se në Mocionin Paraprak të Thaçit për Juridiksionin ai kërkoi që Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar të rrëzohej bazuar në pavlefshmërinë e caktimit të gjykatës Masëlo si Gjykatëse e Procedurës Paraprake – dhe jo të caktimit të saj si Gjykatëse e Vetme – dhe aspekti i parë nuk u

¹¹² Apeli për Juridiksionin, para. 24. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 25-29. Sipas Thaçit, caktimi nga Kryetarja i një gjykatëseje në të dy rolet, si Gjykatëse e Vetme dhe si Gjykatëse e Procedurës Paraprake, bie ndesh me: (i) nenin 33(4) të Ligjit, i cili përcakton se "një gjykatës nuk mund të jetë anëtar i ndonjë paneli tjetër në një fazë tjetër të së njëjtës çështje"; dhe (ii) kuadri i paraparë nga neni 33(1) i Ligjit sipas së cilit gjykatësi i procedurës paraprake caktohet vetëm pas parashtrimit të aktakuzës. Shih Apelin për Juridiksionin, para. 25-28. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 29. Gjithashtu, Thaçi argumenton se këtë rol të dyfishtë si Gjykatës i Vetëm dhe pastaj si Gjykatës i Procedurës Paraprake në të njëjtin proces e kishte pasur fillimisht gjykatësi Giju dhe, pas dorëheqjes së tij, gjykatësja Masëlo. Shih Apelin për Juridiksionin, para. 26.

¹¹³ Apeli për Juridiksionin, para. 30.

¹¹⁴ Apeli për Juridiksionin, para. 31.

trajtua në Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin.¹¹⁵ Gabimi i dytë që ngre Thaçi në lidhje me këtë është se, edhe sikur arsyetimi në Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin do të kishte qenë i vlefshëm edhe për caktimin e gjykatës së Masëlo si Gjykatëse e Procedurës Paraprake, gjykatësja Masëlo nuk i shqyrtoi argumentet e Mbrojtjes në lidhje me nenin 33 të Ligjit, duke u shprehur se nuk kishte kompetencë të shqyrtonte përputhshmërinë e caktimit të saj si Gjykatëse e Procedurës Paraprake me nenin 33 të Ligjit.¹¹⁶ Thaçi pretendon se, në vend të kësaj, Gjykatësja e Procedurës Paraprake në mënyrë të gabuar identifikoi rregullën 20 të Rregullores si të vetmen dispozitë në bazë të së cilës mund të paraqitej kërkesë për heqjen e saj.¹¹⁷

52. Sipas Thaçit, në qoftë se një gjykatës i caktuar nuk është kompetent për të vlerësuar ligjshmërinë e caktimit të vet, rezultati do të ishte mosekzistenca e një forumi për të kundërshtuar caktimin e gjykatësve prej Kryetares, gjë që do ta bënte nenin 33 të Ligjit "të pazbatueshëm dhe të pakuptimtë".¹¹⁸ Gjithashtu, ai argumenton se ky interpretim shkel të drejtat e Thaçit sipas Kushtetutës së Kosovës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ"), dhe se, në mungesë të një forumi për të kundërshtuar ligjshmërinë e gjykatës që po e gjykon, duhet të zbatohet parimi i përgjithshëm i "kompetencës për kompetencën", sipas të cilit Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka autoritet ligjor të vetvetishëm të vendosë lidhur me kompetencën e vet.¹¹⁹

¹¹⁵ Apeli për Juridiksionin, para. 32, që i referohet Mocionit Paraprak të Thaçit për Juridiksionin, para. 87.

¹¹⁶ Apeli për Juridiksionin, para. 33, 56, 58. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 38.

¹¹⁷ Apeli për Juridiksionin, para. 33, 56-58. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 38, 40-43.

¹¹⁸ Apeli për Juridiksionin, para. 33. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 38.

¹¹⁹ Apeli për Juridiksionin, para. 34-37. Kundërpërgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 17-18. Thaçi argumenton gjithashtu se fakti që Gjykatësja e Procedurës Paraprake kishte juridiksion të vetvetishëm për të përcaktuar kompetencën e vet "do të nënkuptonte që ajo të vlerësojë vendimin e Kryetares" "nuk është relevant", sikurse u shpreh Dhoma e Apelit të TPNJ-së në çështjen *Tadiq*, pasi kompetenca për kompetencën i mundësoi TPNJ-së të shqyrtonte ligjshmërinë e krijimit të vet, edhe kur kjo kërkonte konstatim mbi ligjshmërinë e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ("KB"). Shih Apelin për Juridiksionin, para.37, që i referohet ICTY, *Prosecutor v. Tadić*, IT-94-1-A, Decision on the Defence Motion for Interlocutory Appeal on Jurisdiction, 2 October 1995 ("*Tadić* Appeal Decision on Jurisdiction"), para. 17-22.

53. Në Pikën 3, Thaçi argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi që vendosi se rregulla 20 e Rregullores e ndalon Mbrojtjen të kundërshtojë praktikën e caktimit të së njëjtës gjykatëse si Gjykatëse e Vetme dhe si Gjykatëse e Procedurës Paraprake me anë të një mocioni paraprak.¹²⁰ Ai parashtron gjithashtu se konstatimi i Gjykatësës së Procedurës Paraprake në lidhje me argumentin e Mbrojtjes për caktimin e saj në dy role, se kjo ishte “plotësisht në përputhje” me rregullën 20 të Rregullores, është i paarsyetuar – sepse "nuk jep *asnjë* arsye që shpjegon përfundimin e saj mbi zbatueshmërinë e rregullës 20" – dhe është ligjërisht i gabuar.¹²¹ Thaçi argumenton se një mocion i bazuar në shkelje të nenit 33 të Ligjit, ndryshon kryekëput nga kërkesa për vetëtërheqje ose heqje të gjykatësve sipas rregullës 20 të Rregullores, pasi aspektet në lidhje me paanësinë e një gjykatësi nuk janë relevante për faktin nëse gjykatësi është caktuar në mënyrën e duhur apo jo.¹²² Sipas Thaçit, disa shkelje të nenit 33 të Ligjit mund të përfshijnë edhe aspekte të anësisë sipas rregullës 20 të Rregullores, por moskundërshtimi i anësisë së një gjykatësi nuk ndikon në aspektin nëse caktimi i tij u bë mënyrë të rregullt apo jo.¹²³ Sa i përket kohës së paraqitjes së kësaj kërkesë, Thaçi argumenton se efekti i shkeljes së nenit 33 të Ligjit nga Kryetarja është se gjykatësi nuk ka kompetencë – fakt që nuk ndryshon pavarësisht kohës së paraqitjes së kundërshtimit.¹²⁴ Gjithashtu, Thaçi parashtron se Ligji ka përparësi ndaj Rregullores dhe se me rregullën 20 të Rregullores synohet të ofrohet mbrojtje shtesë, jo të zvogëlohen ato të përcaktuara në Ligj.¹²⁵

54. Së fundi, Thaçi parashtron se, ndonëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake pretendoi se në vijim do të shqyrtonte themelësinë e argumenteve të Mbrojtjes, ajo u

¹²⁰ Apeli për Juridiksionin, para. 41-42, 51. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 39-40.

¹²¹ Apeli për Juridiksionin, para. 42-44.

¹²² Apeli për Juridiksionin, para. 45-46, 48. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 19. Thaçi parashtron gjithashtu se procedura sipas rregullës 20 të Rregullores ofron mundësinë që gjykatësi në fjalë të dëgjohej personalisht, që do të ishte "tërësisht e pavend" nëse aspekti i ngritur është një shkelje e nenit 33 të Ligjit. Shih Apelin për Juridiksionin, para. 47.

¹²³ Apeli për Juridiksionin, para. 48. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 49; Kundërpërgjigja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 19-21.

¹²⁴ Apeli për Juridiksionin, para. 46-47.

¹²⁵ Apeli për Juridiksionin, para. 50; Kundërpërgjigja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 21-22.

përqendrua në aspektin nëse ajo është apo jo e paanshme, e jo nëse caktimi i saj ishte në shkelje të nenit 33 të Ligjit, duke vazhduar kështu arsyetimin e gabuar duke i trajtuar argumentet e ndryshme të Thaçit në lidhje me këto dispozita si një të vetëm.¹²⁶

55. Në përgjigje ndaj Pikës 2, ZPS-ja parashtron se Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi saktë se nuk mund të rishikonte ligjshmërinë e caktimit të saj dhe dha arsyetim të mjaftueshëm për këtë.¹²⁷ ZPS-ja i përgjigjet argumentit të Thaçit se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk i trajtoi shprehimisht argumentet e tij dhe parashtron se ajo iu përgjigj drejtpërdrejt argumenteve të tij në Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin.¹²⁸ Në veçanti, ZPS-ja vë në dukje konstatimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake se: (i) ajo është kompetente për të kryesuar procedurën në Çështjen 12, (ii) caktimi i gjykatësve është kompetencë e Kryetares në bazë të nenit 33 të Ligjit, dhe (iii) përshtatshmëria e caktimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake hyn në fushëveprimin e rregullës 20 të Rregullores dhe procedura e duhur për të kërkuar heqjen e një gjykatësi përcaktohet në të.¹²⁹ ZPS-ja argumenton se Thaçi duhej t'i kishte parashtruar kërkesë Kryetares brenda afatit përkatës sipas rregullës 20 të Rregullores dhe se mosparashtrimi i kërkesës nuk çon në mohim të së drejtës së tij (ose mungesë forumi) për kundërshtimin e vendimit të Kryetares për caktimin e gjykatësës në shkelje të nenit 13 të KEDNJ-së.¹³⁰

¹²⁶ Apeli për Juridiksionin, para. 52-58, që i referohen Vendimit të Apeluar mbi Juridiksionin, para. 40. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 23.

¹²⁷ Përgjigja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 23, 30. Shih gjithashtu Përgjigjen ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 28-29.

¹²⁸ Përgjigja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 23, 29-30.

¹²⁹ Përgjigja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 23, 30, që i referohet Vendimit të Apeluar mbi Juridiksionin, para. 36-40.

¹³⁰ Përgjigja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 23-24. Shih gjithashtu Përgjigjen ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 32. ZPS-ja thekson gjithashtu se Thaçi padyshim e njihte procedurën për heqjen e një gjykatësi sipas rregullës 20 të Rregullores, pasi u mbështet në atë dispozitë dy herë kur kërkoi heqjen e gjykatësit Giju. Shih Përgjigjen ndaj Apelit në lidhje me Juridiksionin, para. 24 që i referohet KSC-BC-2018-01, F00615, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Zëvendësimin ose Vetëtërheqjen e një Gjykatësi, 14 mars 2024 ("Kërkesa për Vetëtërheqje të Gjykatësit e 14 marsit 2024"), para. 1, 12; KSC-BC-2018-01, F00687, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Zëvendësimin ose Heqjen e një Gjykatësi, 28 maj 2024 ("Kërkesa për Heqje të Gjykatësit e 28 maj 2024"), para. 1, 12.

56. ZPS-ja gjithashtu argumenton se parimi i "kompetencës për kompetencën" në këtë rast nuk ka të bëjë me autoritetin dhe kompetencat e Gjykatës së Procedurës Paraprake për të rishikuar caktimin e saj, pasi Kryetarja cakton përbërjen e panelit në një çështje të veçantë me urdhër administrativ dhe gjykatësit e caktuar nuk kanë rol në këtë vendim.¹³¹ Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Gjykata e Apelit tashmë ka sqaruar në Vendimin e Apelit mbi Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë se aspektet e autoritetit dhe kompetencës së Gjykatës së Procedurës Paraprake nuk kanë të bëjnë me juridiksionin.¹³² Së fundi, ZPS-ja parashtron se aspekti relevant në Pikën 2 është nëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka kompetencën ta rishikojë caktimin e saj *tani* në kontekstin e vendimit mbi mocionin paraprak dhe, sipas ZPS-së, korniza ligjore e Dhomave të Specializuara nuk i jep asaj kompetencë për të rishikuar vendimet e Kryetares.¹³³

57. Lidhur me Pikën 3, ZPS-ja argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi drejt se dispozita e zbatueshme është rregulla 20 e Rregullores.¹³⁴ Në veçanti, ZPS-ja përgjigjet se Thaçi anashkalon faktin se rregulla 20 e Rregullores përmban rrethana joshteruese që mund të çojnë në vetëtërheqjen ose heqjen e një gjykatësi për çfarëdo përfshirjeje që cenon paanësinë ose integritetin e procesit, dhe se ajo është dispozita e duhur në bazë të së cilës Thaçi duhej të kishte paraqitur pretendimet e tij për parregullsi në lidhje me përfshirje të mëparshme të gjykatësve që mund të cenonin integritetin e procesit.¹³⁵ ZPS-ja në fund argumenton se, gjithsesi, edhe nëse rregulla 20 nuk do të ishte e zbatueshme, Thaçi mund t'i kishte kundërshtuar vendimet e Kryetares sipas nenit 45 të Ligjit dhe rregullave 75, 77 dhe/ose 79 të Rregullores para panelit kompetent në kohën e duhur, por nuk e bëri këtë.¹³⁶

¹³¹ Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 26.

¹³² Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 26.

¹³³ Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 27 (theximi në origjinal).

¹³⁴ Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 32. Shih gjithashtu Përgjigjen ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 23, 31.

¹³⁵ Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 32.

¹³⁶ Përgjigjja ndaj Apelit për Juridiksionin, para. 25, 34.

58. Thaçi i kundërpërgjigjet së pari argumentit të ZPS-së për ekzistencën e mundësive të tjera për rishikimin e caktimit të Gjykatës së Procedurës Paraprake, dhe argumenton se neni 45 i Ligjit nuk lejon apelimin e vendimeve të Kryetares.¹³⁷ Thaçi shton se në Rregulloren për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara përcaktohet se zgjedhja e një gjykatësi prej Kryetares nuk është objekt i rishikimit gjyqësor dhe shton se nuk kishte gjetur ndonjë rast të ndonjë tribunali penal ndërkombëtar ku caktimi i gjykatësit prej Kryetarit të ishte apeluar.¹³⁸ Lidhur me zbatimin ose jo të parimit "kompetenca për kompetencën", Thaçi kundërpërgjigjet se (i) Vendimi i Apelit mbi Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë nuk kishte të bënte me këtë parim,¹³⁹ (ii) nuk ka asgjë që sugjeron se zbatimi i këtij parimi duhet të kufizohet në të njëjtën mënyrë si rregulla 97(1) të Rregullores, që i referohet juridiksionit të Dhomave të Specializuara,¹⁴⁰ dhe (iii) nuk ka asgjë në Ligj që përjashton "kompetencën për kompetencën" dhe shumë gjykata penale ndërkombëtare kanë konstatuar se ky parim zbatohet edhe kur nuk përmendet shprehimisht në statutet e tyre.¹⁴¹

59. Thaçi gjithashtu kundërpërgjigjet se është e palogjikshme që rregulla 20 e Rregullores të kufizojë kriteret e nenit 33 të Ligjit në mënyrë të tillë që ato të aktivizohen vetëm kur mund të mund të demonstronhet anësi reale ose e perceptuar, dhe të jenë të pazbatueshme në mungesë të kundërshtimit nga një palë.¹⁴²

¹³⁷ Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 11.

¹³⁸ Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 12-13, që i referohen KSC-BD-02, Rregullore për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtare, 14 mars 2017 ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), rregulla 3(4).

¹³⁹ Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 14.

¹⁴⁰ Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 15. Thaçi gjithashtu parashton se vetë gjykatësja Masëlo ka vepruar *proprio motu* për të përcaktuar kompetencat e saj në lidhje me një aspekt konkret, duke ushtruar parimin "kompetenca për kompetencën" për aspekte që nuk përfshihen në rregullën 97(1) të Rregullores. Shih Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 16.

¹⁴¹ Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 17-18.

¹⁴² Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 22.

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

60. Paneli vëren se më 6 qershor 2024, Kryetarja caktoi gjykatësen Masëlo si Gjykatëse të Vetme në procedurat në kuadër të KSC-BC-2018-01 dhe Thaçi u njoftua po atë ditë.¹⁴³ Po më 6 qershor 2024, Kryetarja caktoi gjykatësen Masëlo si Gjykatëse të Procedurës Paraprake në Çështjen 12, dhe Thaçi u njoftua për këtë vendim më 11 dhjetor 2024.¹⁴⁴

61. Paneli vëren gjithashtu se më 14 prill 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake caktoi 8 majin 2025 si afat për dorëzimin e mocioneve paraprake të Mbrojtjes në Çështjen 12, në përputhje me rregullën 97(1) të Rregullores dhe nenin 39(1) të Ligjit për: (i) kundërshtimin e juridiksionit të Dhomave të Specializuara; (ii) ngritjen e pretendimeve për mangësi në formën e aktakuzës; ose (iii) kërkimin e veçimit të akuzave sipas rregullës 89(2) të Rregullores.¹⁴⁵

62. Në Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se: (i) ajo vetë nuk ka kompetencë të shprehet në lidhje me caktimin e saj, që është plotësisht në kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryetares së Dhomave të Specializuara; dhe (ii) argumenti i Mbrojtjes së Thaçit se caktimi i të njëjtës gjykatëse si Gjykatëse e Vetme dhe Gjykatëse e Procedurës Paraprake ishte i palejueshëm, përfshihet plotësisht në fushëveprimin e rregullës 20 të Rregullores.¹⁴⁶

63. Fillimisht, Paneli i Apelit rikujton se e konstatoi të papranueshëm Apelin e Drejtpërdrejtë të Thaçit mbi Pranueshmërinë – që u parashtrua mbi bazën e së drejtës së vetvetishme për apel – kundër konstatimit të Gjykatës së Procedurës Paraprake se kundërshtimi ndaj kompetencës së saj për të vendosur mbi aspekte të procedurës

¹⁴³ Shih Vendimin për Caktimin e Gjykatës së Vetme.

¹⁴⁴ Shih Vendimin për Caktimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake. Paneli vëren se Vendimi për Caktimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake u lëshua si konfidencial më 6 qershor 2024, dhe më 11 dhjetor 2024 ky vendim u riklasifikua si publik dhe iu njoftua Thaçit.

¹⁴⁵ Vendimi për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake, para. 11, 30, 31(h).

¹⁴⁶ Vendimi i Apeluar mbi Juridiksionin, para. 38-39. Shih gjithashtu Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin, para. 37, 40-41.

paraprake në Çështjen 12 nuk përbënte kundërshtim të juridiksionit sipas rregullës 97(1)(a) të Rregullores.¹⁴⁷ Paneli konstatoi, ndër të tjera, se ky kundërshtim ndaj kompetencës dhe autoritetit të Gjykatës së Procedurës Paraprake, nuk kishte të bënte *stricto sensu* me juridiksionin personal, territorial, kohor ose lëndor të Dhomave të Specializuara sipas nenit 45(2) të Ligjit dhe, rrjedhimisht, nuk përbënte kundërshtim ndaj juridiksionit sipas rregullës 97(1)(a) të Rregullores.¹⁴⁸

64. Gjithashtu, Paneli i Apelit mban parasysh parashtrimet paraprake të Thaçit në Apelin për Juridiksionin se caktimi i gjykatës Masëlo si Gjykatë e Vetme dhe Gjykatë e Procedurës Paraprake ishte në shkelje të nenit 33 të Ligjit.¹⁴⁹ Paneli gjykon se këto parashtrime dalin jashtë kuadrit të Pikës së Dytë dhe Pikës së Tretë për të cilat u dha leje për apel¹⁵⁰ dhe rikujton se shqyrtimi i Panelit kufizohet vetëm në pikat e autorizuara për apel nga paneli i shkallës më të ulët.¹⁵¹ Rrjedhimisht, Paneli refuzon t'i shqyrtojë këto argumente dhe i rrëzon ato nga pikëpamja formale.¹⁵²

¹⁴⁷ Vendimi i Apelit mbi Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë, para. 19-23. Shih Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë, para. 20-35.

¹⁴⁸ Shih Vendimin e Apelit mbi Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë, para. 20. Paneli kujton se në këtë vendim ai vuri në dukje nuk dot të trajtonte themelësinë e apelit të Thaçit, për aq sa ishte e mundur, dhe se do të trajtonte vetëm argumentet që lidhen specifikisht me aspektin e pranueshmërisë. Shih Vendimin e Apelit mbi Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë, para. 5.

¹⁴⁹ Shih Apelin për Juridiksionin, para. 24-30. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 49, 54; Kundërpërgjigja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 19.

¹⁵⁰ Shih Vendimin mbi Lejen për Apel për Juridiksionin, para. 31-35, ku pika e dytë e autorizuar është formuluar kështu: "nëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake bëri gabim ligjor që gjykoi se nuk mund të rishikonte ligjshmërinë e caktimit të saj dhe dha arsye të pamjaftueshme për këtë", dhe pika e tretë e autorizuar është formuluar kështu: "nëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake bëri gabim ligjor që konstatoi se rregulla 20 e Rregullores e ndalon Mbrojtjen të kundërshtojë, me anë të një mocioni paraprak, praktikën e emërimit të të njëjtit gjykatës edhe si Gjykatës i Vetëm, edhe si Gjykatës i Procedurës Paraprake, dhe dha arsye të pamjaftueshme për këtë" Shih gjithashtu më lart, para. 13.

¹⁵¹ Shih KSC-BC-2020-06, IA036/F00011, IA037/F00011, IA038/F00011, IA040/F00011, Vendim mbi Apelin Përmbledhës të Përbashkët të Mbrojtjes kundër Vendimeve F03201, F03202, F03203, F03211 dhe F03213, 8 tetor 2025, para. 16; KSC-BC-2020-06, IA031/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin kundër Vendimit Gojor të 5 dhjetorit 2024, 11 prillit 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 11 prill 2025), para. 10.

¹⁵² Lidhur me këtë, Paneli vëren se Kryetarja sqaroi pikën e kundërshtuar nga Thaçi në një vendim me anë të të cilit emëroi gjykatësin Giju si Gjykatës të Vetëm të parë, me konstatimin se "në përputhje me nenin 33(4) të Ligjit, Gjykatësi i Vetëm i caktuar në këtë vendim nuk mund të jetë gjykatës në një trup gjykues në një fazë tjetër të së njëjtës çështje, përveç se si Gjykatës i Procedurës Paraprake" dhe se sipas

(a) Pika 2

65. Në lidhje me Pikën 2 të Apelit të Thaçit për Juridiksionin, me sa kupton Paneli, ai kundërshton caktimin e gjykatëses Masëlo si Gjykatëse e Procedurës Paraprake.¹⁵³

Në veçanti, Thaçi kundërshton konstatimet e Gjykatëses së Procedurës Paraprake në Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin se, në bazë të nenit 33 të Ligjit, caktimi i gjykatësve është vetëm në kompetencën e Kryetares dhe, rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ka kompetencë "të japë mendim për këtë aspekt, pasi kjo do të thoshte që ajo të gjykojë drejtësinë e vendimit përkatës të Kryetares".¹⁵⁴

66. Sa u përket argumenteve të Thaçit në lidhje me vlefshmërinë e caktimit të Gjykatëses së Procedurës Paraprake, Paneli fillimisht vëren se Thaçi ka paraqitur më parë kundërshtim ndaj diskrecionit të Kryetares për caktimin e gjykatësve nga Regjistri i Gjykatësve gjatë fazës së procedurës paraprake të procesit në Çështjen 06.¹⁵⁵

Në lidhje me këtë, Paneli vë në dukje se në Çështjen 06, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykoj se Kryetarja "ka kompetencën" të caktojë gjykatësit nga Regjistri i

neneve 25(1)(f) dhe 33(2) të Ligjit të interpretuara së bashku, në Dhoma mund të ketë gjykatës individualë që kryejnë funksione të tjera të parapara sipas Ligjit, për të trajtuar çështje për të cilat, sipas Kryetares, duhet të caktohet një gjykatës tjetër nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Rrjedhimisht, këto dispozita kanë për qëllim identifikimin e rasteve ku duhet të caktohet një gjykatës individual për të trajtuar një çështje konkrete pa përfshirë kushtet që zbatohen për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake sipas nenit 33(1) të Ligjit." Shih KSCPR-2018/F00004, Vendim për Caktimin e një Gjykatësi të Vetëm sipas Nenit 33(2) të Ligjit, 29 maj 2018 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, i riklasifikuar si publik më 28 shtator 2020), para. 11, 17 (theksimi i shtuar).

¹⁵³ Paneli vëren se Thaçi argumenton se në Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin. Gjykatësja e Procedurës Paraprake trajtoi vlefshmërinë e caktimit të saj si Gjykatëse e Vetme, ndërkohë që kundërshtimi i tij kishte të bënte me caktimin e saj si Gjykatëse e Procedurës Paraprake. Sidoqoftë, Paneli mban parasysh gjithashtu parashtrimin e Thaçit se, edhe kur ndoqi të njëjtin arsyetim në Vendimin e Apeluar për caktimin e saj si Gjykatëse e Procedurës Paraprake, ajo gaboi për të njëjtat arsye, pavarësisht nëse kishte të bënte me caktimin e saj si Gjykatëse e Vetme apo si Gjykatëse e Procedurës Paraprake. Shih Apelin për Juridiksionin, para. 32, (që i referohet Mocionit Paraprak të Thaçit për Juridiksionin, para. 87), 33, 56-58; Vendimi i Apeluar mbi Juridiksionin, para. 38. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 31, 38, 40-43. Bazuar në këto parashtrime, Paneli do të trajtojë kundërshtimet e Thaçit lidhur me caktimin e gjykatëses Masëlo si Gjykatëse e Procedurës Paraprake.

¹⁵⁴ Shih Apelin për Juridiksionin, para. 31, 33, 38. Shih Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin, para. 38.

¹⁵⁵ Shih KSC-BC-2020-06/F00450, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve, 31 gusht 2021. ("Vendimi mbi Kundërshtimin e Ligjshmërisë në çështjen Thaçi dhe të tjerët"), para. 90. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F00217, Mocion për kundërshtimin e juridiksionit mbi bazën e shkeljes së të drejtave themelore të mishëruara në Kushtetutë, 12 mars 2021, para. 48.

Gjykatësve, në përputhje me nenet 32(3) dhe 33 të Ligjit, së bashku me Rregulloren për Caktimin e Gjykatësve që "e udhëzon Kryetarin në këtë drejtim".¹⁵⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu gjykoi se "korniza ligjore për caktimin e gjykatësve në [Dhomat e Specializuara] vendos kritere të parapërcaktuara, të përgjithshme dhe objektive, të cilat ofrojnë garanci kundër caktimit të gjykatësve për motive të palejueshme" dhe konstatoi se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara në lidhje me rolin e Kryetares në caktimin e gjykatësve "nuk vë në dyshim pavarësinë dhe paanësinë" e Dhomave të Specializuara.¹⁵⁷ Paneli i Apelit pajtohet me këto konstatime të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Çështjen 06 bazuar në dispozitat përkatëse në Ligj dhe është i të njëjtit mendim me të se caktimi i gjykatësve sipas nenit 33 të Ligjit është vetëm në kompetencën e Kryetares.

67. Paneli do të trajtojë në vijim mundësinë e rishikimit të caktimit të gjykatësve prej Kryetares, për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me nenin 33 të Ligjit. Fillimisht, Paneli vëren se në bazë të rregullës 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, vendimi i Kryetares për caktimin e tyre "nuk i nënshtrohet rishikimit gjyqësor" dhe, rrjedhimisht, sipas kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ka kompetencë për të rishikuar vendimet e Kryetares.¹⁵⁸ Sidoqoftë, Paneli do të trajtojë argumentet e Thaçit se, në mungesë të një dispozite specifike në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara, zbatohet parimi ligjor "kompetenca për kompetencën", që i jep Gjykatësës së Procedurës Paraprake juridiksion të vetvetishëm të rishikojë kompetencën e saj.¹⁵⁹

¹⁵⁶ ("Vendimi mbi Kundërshtimin e Ligjshmërisë në Çështjen Thaçi dhe të Tjerët"), para. 106.

¹⁵⁷ ("Vendimi mbi Kundërshtimin e Ligjshmërisë në Çështjen Thaçi dhe të Tjerët"), para. 106. Shih gjithashtu IA013/F00012, Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve, 20 maj 2022, para. 45-49.

¹⁵⁸ Shih Rregulloren për Caktimin e Gjykatësve, rregulla 3(4).

¹⁵⁹ Shih Apelin për Juridiksionin, para. 34-37. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 14-18.

68. Paneli mban parasysh argumentin e Thaçit se, në Çështjen *Tadiq*, Dhoma e Apelit e TPNJ-së u mbështet në parimin "kompetenca për kompetencën" për rishikimin e ligjshmërisë së krijimit të TPNJ-së.¹⁶⁰ Paneli vëren se gjatë zbatimit të atij parimi, Dhoma e Apelit e TPNJ-së konstatoi se TPNJ-ja kishte autoritetin ligjor "të shqyrtonte pretendimin e ngritur kundër juridiksionit të saj bazuar në pavlefshmërinë e themelimit të saj nga Këshilli i Sigurimit".¹⁶¹

69. Paneli vëren se jurisprudenca mbi parimin "kompetenca për kompetencën" ka të bëjë me kompetencën e një tribunali për të përcaktuar juridiksionin e vet.¹⁶² Ajo ka të bëjë me kompetencën e vetvetishme të tribunalit për të rishikuar *juridiksionin* e vet. Megjithatë, Paneli i Apelit gjykon se ky parim nuk ka të bëjë me pyetjen nëse një gjykatës i vetëm mundet ose jo të vlerësojë *aktimin* ose statusin e vet. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton gjithashtu konstatimin e vet se kundërshtimi i Thaçit në lidhje me kompetencën e Gjykatës së Procedurës Paraprake për drejtuar procedurat paraprake në Çështjen 12 nuk është kundërshtim ndaj juridiksionit sipas rregullës

¹⁶⁰ Shih Apelin për Juridiksionin, para. 37, që i referohet *Tadić Appeal Decision on Jurisdiction*, paras 17-22.

¹⁶¹ *Tadić Appeal Decision on Jurisdiction*, para. 22. Krahaso: *Tadić Appeal Decision on Jurisdiction*, para. 22 me STL, Prosecutor v. Ayyash et al., STL-11-01/PT/AC/AR90.1, Decision on the Defence Appeals Against the Trial Chamber's "Decision on the Defence Challenges to the Jurisdiction and Legality of the Tribunal", 24 October 2012, paras 40-45 (ku Dhoma e Apelit e Tribunalit Special për Libanin vuri në dukje se, duke pasur parasysh jurisprudencën tjetër ndërkombëtare, çështja *Tadiq* ishte përjashtim, u shpreh se ajo kishte autoritet ligjor për të shqyrtuar si gjykatë veprimet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe konstatoi se arsyetimi i dhënë në çështjen *Tadiq* ishte jobindës duke refuzuar ta pranonte atë).

¹⁶² Paneli vëren se parimi "kompetenca për kompetencën" (i përmendur edhe si "*compétence de la compétence*" ose "*Kompetenz-Kompetenz*") i referohet juridiksionit të vetvetishëm të çdo tribunali gjyqësor ose arbitrazhi, ose "juridiksionit për të përcaktuar juridiksionin e vet". Shih *Tadić Appeal Decision on Jurisdiction*, para. 18. Bazuar në këtë parim, gjykatat ndërkombëtare kanë konstatuar se "në mungesë të marrëveshjeve në të kundërt, një tribunal ndërkombëtar ka të drejtën të vendosë për juridiksionin e vet dhe për këtë ka autoritetin të interpretojë instrumentet që përcaktojnë këtë juridiksion". Shih ICJ, *Nottebohm case (Liechtenstein v. Guatemala)*, Preliminary Objection, ICJ Reports 1953 (p. 111), Judgment, 18 November 1953, p. 119; ICC, ICC-RoC46(3)-01/18-37, Decision on the "Prosecution's Request for a Ruling on Jurisdiction under Article 19(3) of the Statute", 6 September 2018, paras 30-33, dhe referencat e cituara aty; STL, *In the matter of El Sayed*, CH/AC/2010/02, Decision on Appeal of Pre-Trial Judge's Order Regarding Jurisdiction and Standing, 10 November 2010 ("*El Sayed Appeal Decision*"), para. 43. Shih gjithashtu *El Sayed Appeal Decision*, paras 44-49, dhe referencat e cituara aty.

97(1)(a) të Rregullores.¹⁶³ Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentin e Thaçit për zbatueshmërinë e parimit kompetenca për kompetencën.

70. Paneli do të trajtojë tani pretendimin e Thaçit se, në qoftë se gjykatësi i caktuar nuk është kompetent për të vlerësuar ligjshmërinë e caktimit të vet, atëherë mungon forumi në të cilin mund të kundërshtohet caktimi i gjykatësve prej Kryetares sipas nenit 33 të Ligjit, që është në shkelje të të drejtave të Thaçit sipas Kushtetutës së Kosovës dhe KEDNJ-së.¹⁶⁴ Përkundër asaj që argumenton Thaçi dhe sikurse shtjellohet më tej më poshtë në lidhje me Pikën 3, Paneli vëren se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara faktikisht përcakton rrugën që duhet të ndjekë një palë për të kundërshtuar caktimin e një gjykatësi prej Kryetares, pasi në rregullën 20 të Rregullores përcaktohet procedura e duhur. Paneli gjykon se duke pasur parasysh këtë procedurë, të drejtat e Thaçit sipas Kushtetutës së Kosovës dhe KEDNJ-së nuk janë shkelur, dhe, rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentet e Thaçit.

(b) Pika 3

71. Paneli do të trajtojë tani argumentet e Thaçit në Pikën 3. Paneli fillimisht vëren kundërshtimet e Thaçit ndaj konstatimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake në Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin se Thaçi mund ta kishte ngritur, dhe duhet ta kishte ngritur, këtë aspekt – që caktimi i së njëjtës gjykatëse edhe si Gjykatëse e Vetme edhe si Gjykatëse e Procedurës Paraprake ishte i palejueshëm – sipas procedurës së përcaktuar në rregullën 20(3) të Rregullores dhe se ai nuk mund t'i anashkalojë procedurën dhe afatet në këtë fazë të vonë të procesit.¹⁶⁵

72. Paneli vëren se në rregullën 20(3) të Rregullores përcaktohet se "një palë mund t'i paraqesë Kryetarit kërkesë për heqjen e menjëhershme të një gjykatësi, por jo më

¹⁶³ Shih Vendimin e Apelit mbi Apelin e Drejtpërdrejtë për Pranueshmërinë, para. 19-20. Duke qenë se konstatoi se në këto rrethana parimi "kompetenca për kompetencën" nuk zbatohet, Paneli nuk do të trajtojë më tej parashtrimet e Thaçit të paraqitura në kundërpërgjigje në lidhje me këtë parim. Shih Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 14-18.

¹⁶⁴ Apeli për Juridiksionin, para. 33-36. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 38.

¹⁶⁵ Shih Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin, para. 39.

vonë se dhjetë (10) ditë pasi pala në fjalë të ketë marrë dijëni për arsyet mbi të cilat mbështet kërkesën për heqjen e atij gjykatësi". Paneli vëren gjithashtu se në rregullën 20(1) të Rregullores jepet një listë joshteruese e arsyeve që ("*mund të shërbejnë*") për vetëtërheqjen ose heqjen e gjykatësve.¹⁶⁶ Po kështu, Paneli mban parasysh formulimin e rregullës 20(1)(d) të Rregullores, ku përcaktohet se si arsye për heqjen e gjykatësve mund të shërbejë "çfarëdo arsyeje tjetër që logjikisht mund të perceptohet se ndikon në paanshmërinë e gjykatësit". Sipas Panelit, formulimi i rregullës 20 të Rregullores parashikon arsye të gjera dhe gjithëpërfshirëse, në bazë të të cilave një palë mund të bëjë kërkesë për heqjen e një gjykatësi në Dhomat e Specializuara. Në lidhje me këtë, Paneli gjykon se këto arsye për heqjen e gjykatësit nuk janë aq të kufizuara sa pretendon Thaçi – d.m.th. vetëm kur ka konflikt të mundshëm interesi ose ndikim në paanshmërinë e gjykatësit – por mbulojnë çdo përfshirje që cenon paanshmërinë, pavarësinë gjyqësore ose integritetin e procesit.¹⁶⁷ Rrjedhimisht, Paneli pajtohet me konstatimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake se argumenti i Thaçit për

¹⁶⁶ Shih rregullën 20(1) të Rregullores (theksimi i shtuar). Paneli vë në dukje se rregulla 20(1) e Rregullores përcakton se:

Një gjykatës nuk mund të marrë pjesë në një çështje gjyqësore në të cilën gjykatësi ka interes personal ose në të cilën është përfshirë ose ka qenë përfshirë, që mund të ndikojë ose perceptohet se ndikon në paanshmërinë e gjykatësit, në pavarësinë gjyqësore ose në integritetin e procesit. Si arsye për vetëtërheqje ose heqje mund të shërbejnë:

- (a) interesi personal i gjykatësit në çështjen gjyqësore, ndër të tjerë interesi bashkëshortor, prindëror ose një lidhje tjetër familjare e ngushtë, një lidhje personale, profesionale apo vartësie me cilëndo nga palët ose me mbrojtësin e viktimave, si edhe situata që logjikisht mund të perceptohen se shkaktojnë konflikt interesash;
- (b) përfshirja e gjykatësit, jo si gjykatës i Dhomave të Specializuara, në çfarëdo procedure ligjore në të cilën i dyshuari ose i akuzuari ka qenë ose është palë;
- (c) pikëpamja e mundshme e gjykatësit për çështjen në fjalë e krijuar gjatë kryerjes së funksioneve para caktimit të gjykatësit në atë çështje, e cila mund të ndikojë për keq në paanshmërinë e gjykatësit përkatës; dhe
- (d) çfarëdo arsye tjetër që logjikisht mund të perceptohet se ndikon në paanshmërinë e gjykatësit.

¹⁶⁷ Shih Apelin për Juridiksionin, para. 33, 45-46, 48. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 19. Paneli vë në dukje se në Mocionin Paraprak për Juridiksionin, Thaçi fillimisht kundërshtoi caktimin e të njëjtës gjykatëse edhe si Gjykatëse e Vetme edhe si Gjykatëse e Procedurës Paraprake, duke pretenduar se, për shkak të përfshirjes së saj të mëhershme si Gjykatëse e Vetme, gjykatësja Masëlo (dhe përpara saj, gjykatësi Giju) nuk është objektive dhe e paanshme. Shih Mocionin Paraprak të Thaçit për Juridiksionin, para. 70-81. Paneli vëren se, në Apelin për Juridiksionin, Thaçi duket se nuk përqendrohet më në këtë kundërshtim por në caktimin gjyqësor të pavlefshëm të gjykatësës Masëlo në shkelle të nenit 33 të Ligjit. Shih Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 19. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 33, 45-46, 48.

palejueshmërinë e caktimit të së njëjtës gjykatëse edhe si Gjykatëse e Vetme edhe si Gjykatëse e Procedurës Paraprake, përfshihet në fushëveprimin e rregullës 20 të Rregullores.

73. Sa i përket argumentit të Thaçit se një mocion bazuar në shkelje të nenit 33 të Ligjit ndryshon kryekëput nga kërkesa për vetëtërheqje ose heqje të gjykatësve sipas rregullës 20 të Rregullores, pasi aspektet që lidhen me paanësinë e gjykatësit nuk janë relevante për caktimin në mënyrë të rregullt të tij,¹⁶⁸ Paneli e konstaton këtë argument jobindës për arsyet në vijim. Së pari, Paneli rikujton konstatimin e vet të mëhershëm se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ka kompetencë të rishikojë vendimet e Kryetares sipas nenit 33 të Ligjit.¹⁶⁹ Së dyti, sikurse u konstatua më lart, Paneli rikujton se rregulla e zbatueshme 20 e Rregullores nuk i kufizon kriteret e nenit 33 të Ligjit, që ato "aktivizohen vetëm kur mund të demonstrohet anësi reale ose e perceptuar",¹⁷⁰ duke pasur parasysh listën joshteruese të arsyeve për vetëtërheqjen ose heqjen e gjykatësve.¹⁷¹ Në këtë aspekt, Paneli pajtohet me argumentin e Thaçit se rregulla 20 të Rregullores nuk synon të zvogëlojë garancitë mbrojtëse të përcaktuara në nenin 33 të Ligjit.¹⁷² Duke qenë se Paneli konstatoi se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk mund të rishikonte vendimin për caktimin e saj sipas nenit 33 të Ligjit, Paneli nuk do t'i shqyrtojë më tej argumentet e Thaçit lidhur me kohën e dorëzimit të kërkesave të mundshme për rishikim dhe marrëdhënien midis nenit 33 dhe rregullës 20 në kontekstin e këtij rishikimi.¹⁷³

¹⁶⁸ Apeli për Juridiksionin, para. 45-46, 48. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 19. Thaçi parashtroi gjithashtu se procedura sipas rregullës 20 të Rregullores parasheh mundësinë që gjykatësi në fjalë të dëgjohet personalisht, që do të ishte "tërësisht e pavend" nëse pika e ngritur është një shkelje e nenit 33 të Ligjit. Shih Apelin për Juridiksionin, para. 47.

¹⁶⁹ Shih më lart, para. 67-69.

¹⁷⁰ Shih Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 22.

¹⁷¹ Shih më lart, para. 72.

¹⁷² Shih Apelin për Juridiksionin, para. 50.

¹⁷³ Shih Apelin për Juridiksionin, para. 46-47; Kundërpërgjigjja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 22.

74. Paneli vëren gjithashtu argumentin e Thaçit se, në qoftë se gjykatësi i caktuar nuk ka kompetencë të vlerësojë ligjshmërinë e caktimit të vet, rezultati do të ishte që nuk do të kishte një forum për të kundërshtuar caktimin e gjykatësve prej Kryetares dhe, për më tepër, që zgjedhja e gjykatësit prej Kryetares nuk mund të rishikohet.¹⁷⁴ Megjithatë, Paneli thekson se rregulla 20(3) e Rregullores faktikisht përcakton mundësinë për kundërshtimin e vendimit të Kryetares për caktimin e një gjykatësi. Sipas kësaj dispozite, pala mund t'i paraqesë kërkesë drejtpërdrejt Kryetares, e cila, me përjashtim të rasteve kur kërkesa për heqje të gjykatësit hidhet poshtë me procedurë të shkurtuar në qoftë se, ndër të tjera, është qëllimkeqe ose e pavlerë, "cakton një panel prej tre gjykatësish për marrjen e vendimit në lidhje me heqjen" e gjykatësit. Paneli është i mendimit se Thaçi mund ta kishte shfrytëzuar këtë mundësi për të kundërshtuar vendimin e Kryetares për caktimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake, por nuk e bëri këtë.

75. Në lidhje me këtë, Paneli vëren se Thaçi e ka përdorur dy herë procedurën sipas rregullës 20 të Rregullores për të kërkuar vetëtërheqjen dhe heqjen e Gjykatësit të Vetëm, gjykatësit Giju, në procedurat në kuadër të KSC-BC-2018-01.¹⁷⁵ Paneli gjykon se, sidomos duke pasur parasysh këtë precedent kërkesash të ngjashme nga Thaçi, ku ai e përmend specifikisht kriterin e afatit sipas rregullës 20 të Rregullores,¹⁷⁶ është e qartë se ai kishte dijeni të plotë për mundësitë e kundërshtimit të caktimit të gjykatës

¹⁷⁴ Shih Apelin për Juridiksionin, para. 33-38; Shih Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 12-13, që i referohen rregullës 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

¹⁷⁵ Kërkesa për Vetëtërheqjen e Gjykatësit, 14 mars 2024; Kërkesa për Heqjen e Gjykatësit, 28 maj 2024.

¹⁷⁶ Kërkesa për Vetëtërheqjen e Gjykatësit, 14 mars 2024, para. 18-20; Kërkesa për Heqjen e Gjykatësit, 28 maj 2024, para. 19-21. Paneli vëren gjithashtu se në të dy kërkesat Thaçi kërkon që Kryetarja të caktojë një panel prej tre gjykatësish për të vendosur në lidhje me kërkesat e tij, përkatësisht për vetëtërheqjen dhe heqjen e gjykatësit Giju sipas rregullës 20(3) të Rregullores. Shih Kërkesën për Vetëtërheqjen e Gjykatësit, 14 mars 2024, para. 21- 35, 37; Kërkesën për Heqjen e Gjykatësit, 28 maj 2024, para. 22-33. Paneli vëren se Kërkesa për Vetëtërheqjen e Gjykatësit, e 14 marsit 2024 dhe Kërkesa për Heqjen e Gjykatësit e 28 majit 2024 u rrëzuan nga Kryetarja përkatësisht më 8 prill 2024 dhe 6 qershor 2024. Shih KSC-BC-2018-01, F00630, Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Zëvendësimin ose Vetëtërheqjen e Gjykatësit, 8 prill 2024; Shih KSC-BC-2018-01, F00698, Vendim mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Zëvendësimin ose Vetëtërheqjen e Gjykatësit, 6 qershor 2024.

Masëlo si Gjykatëse e Procedurës Paraprake në këtë proces gjyqësor, si dhe për afatin brenda të cilit duhej bërë kërkesa.¹⁷⁷

76. Lidhur me argumentet e palëve mbi mundësitë e tjera përveç procedurës sipas rregullës 20(3) të Rregullores, që Thaçi mund t'i kishte shfrytëzuar për të kundërshtuar caktimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në këtë proces,¹⁷⁸ Paneli nuk do t'i shqyrtojë ato, bazuar në konstatimet e tij më sipër se rruga për ta bërë këtë është përmes rregullës 20(3) të Rregullores.

77. Së fundi, lidhur me argumentin e Thaçit se Gjykatësja e Procedurës Paraprake "nuk dha asnjë arsye" për zbatueshmërinë e Rregullës 20 të Rregullores për caktimin e saj si Gjykatëse e Vetme dhe si Gjykatëse e Procedurës Paraprake,¹⁷⁹ Paneli përmend konstatimet relevante të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, si vijon: (i) në qoftë se Thaçi besonte se kishte arsye për heqjen e gjykatësës, ai mund dhe duhej ta kishte ngritur këtë aspekt përmes procedurës së përcaktuar në rregullën 20(3) të Rregullores, por nuk e bëri këtë; (ii) tani ai nuk mund të anashkalojë procedurën dhe afatet e zbatueshme duke e ngritur këtë aspekt përmes një mocioni paraprak; (iii) përtej argumentit procedural, Thaçi paraqiti "argumente të përgjithshme dhe të pabaza abstrakte" dhe nuk demonstroi konkretisht se si caktimi i saj si Gjykatëse e Vetme dhe si Gjykatëse e Procedurës Paraprake mund të kishte ndikuar ose të dukej se ndikonte në paanshmërinë e saj; dhe (iv) parashtrimet e Thaçit ishin kundërthënëse dhe

¹⁷⁷ Paneli i Apelit thekson se për të kundërshtuar emërimin e gjykatësës Masëlo si Gjykatëse e Procedurës Paraprake, Thaçi duhej t'i kishte paraqitur kërkesë Kryetares brenda dhjetë ditësh nga marrja e njoftimit të vendimit të saj më 11 dhjetor 2024. Shih më lart, para. 60. Në vend të kësaj, Thaçi e kundërshtoi emërimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake më vonë, përmes një mocioni paraprak, më 8 maj 2025. Shih më lart, para. 8, 61.

¹⁷⁸ Shih Përgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin para. 25, 34., që i referohen nenit 45 të Ligjit dhe rregullave 75, 77 dhe/ose 79 të Rregullores; Kundërpërgjigja në kuadër të Apelit për Juridiksionin, para. 11-13 (ku argumentohet se neni 45 i Ligjit nuk lejon apelimin e vendimeve të Kryetares dhe se, sipas Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, vendimi për zgjedhjen e një gjykatësi ose gjykatëseje prej Kryetares nuk mund të rishikohet).

¹⁷⁹ Shih Apelin për Juridiksionin, para. 42-43.

hipokrite kur argumentoi se paanësia e saj ishte ndikuar nga përfshirja në aspektet hetimore, ndërsa paanësia e gjykatësve të Trupit Gjykues II, jo.¹⁸⁰

78. Paneli vëren se Gjykatësja e Procedurës Paraprake i shqyrtoi dhe iu përgjigj argumenteve relevante të Mbrojtjes ndaj Vendimit të Apeluar mbi Juridiksionin, duke dhënë edhe arsytimin pse konstatoi se në rastin e kundërshtimeve të Thaçit për caktimin e dyfishtë të saj si Gjykatëse e Vetme dhe si Gjykatëse e Procedurës Paraprake zbatohet rregulla 20 e Rregullores, dhe jo neni 33 i Ligjit.¹⁸¹ Ndonëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk iu referua çdo argumenti të ngritur nga Mbrojtja në Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Mocionit Paraprak të Thaçit për Juridiksionin,¹⁸² Paneli rikujton se nuk ekziston detyrimi që një panel të artikulojë çdo hap të arsytimit të vet dhe të diskutojë çdo argument, për sa kohë që jep arsyet në mbështetje të konstatimeve të veta mbi aspektet materiale që janë relevante për vendimin.¹⁸³ Duke pasur parasysh këtë, Paneli konstaton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake arsyetoi mjaftueshëm konstatimin e saj mbi zbatueshmërinë e rregullës 20 të Rregullores në lidhje me kundërshtimin e Thaçit dhe rrëzon argumentin e Thaçit në këtë aspekt.

79. Në përputhje me sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Thaçi nuk ka demonstruar se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi në vlerësimin e ligjshmërisë së caktimit të saj ose të zbatueshmërisë së rregullës 20 të Rregullores në atë kontekst. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 2 dhe Pikën 3 të Apelit për Juridiksionin.

¹⁸⁰ Shih Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin, para. 39-40.

¹⁸¹ Shih Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin, para. 38-40, që u referohen paragrafëve 57, 65-69, 74, 77-78, 82, 87-88 të Mocionit Paraprak të Thaçit për Juridiksionin.

¹⁸² Shih Apelin për Juridiksionin, para. 40. Shih gjithashtu Apelin për Juridiksionin, para. 39, 42; Shih Vendimin e Apeluar mbi Juridiksionin, para. 38-40; F00318, Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Mocionit Paraprak për Juridiksionin, 30 maj 2025 (konfidencial dhe *ex parte*, e riklasifikuar si publike më 27 qershor 2025), para. 18-25.

¹⁸³ Shih p.sh. Aktgjykimin e Apelit të Shalës, para. 43; KSC-BC-2020-06, IA009, F00030, Vendim mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, publik, 23 dhjetor 2021, para. 154..

V. VENDIM

80. Për arsyet e lartpërmendura, Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit:

RRËZON Apelet në tërësinë e tyre.

MIRATON Kërkesën e ZPS-së për Riklasifikim dhe Kërkesën e Thaçit për Riklasifikim; dhe

UDHËZON Zyrën Administrative të klasifikojë si publike Përgjigjen ndaj Apelit për Shtyrjen e Procesit (IA006/F00005), Përgjigjen ndaj Apelit për Juridiksionin (IA007/F00005), Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Shtyrjen e Procesit (IA006/F00007), Kundërpërgjigjen në kuadër të Apelit për Juridiksionin (IA007/F00006), Kërkesën e ZPS-së për Riklasifikim (IA006/F00006) dhe Kërkesën e Thaçit për Riklasifikim (IA006/F00008), në bazë të rregullës 82(5) të Rregullores.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar

Kryegjykatëse

E martë, 28 tetor 2025

Hagë, Holandë